



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” në
“Financë - Kontabilitet”
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. As. Dr. Gentiana Sharku
Dr. Valbona Kapllani**

Dhjetor / 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master Profesional në "Financë - Kontabilitet"

1	IAL aplikues:	Universiteti "Fan S. Noli", Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financë Kontabilitetit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në: "Financë - Kontabilitet"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 672, datë 14.09.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 575, datë 01.10.2018 Miratuar me shkresë MASR, Nr. 1287/1 prot, datë 15.03.2019
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 323, datë 05.06.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE / 0 PAK
18	Numri i studentëve (3 vitet e fundit)	(35+35+36) = 106
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës është Institucion i Arsimit të Lartë Publik, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë Nr.5, datë, 07.01.1992, mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor (ILB), themeluar në vitin 1971 me emrin “Universiteti Politeknik i Korçës”. Emri zyrtar këtij universiteti “Fan S. Noli” i është dhënë në vitin 1994, me vendim të Këshillit të Ministrave. Universiteti “Fan S. Noli” përbëhet nga katër njësi kryesore:

1. Fakulteti i Bujqësisë;
2. Fakulteti i Edukimit dhe Folologjisë;
3. Fakulteti i Ekonomisë;
4. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane;

Programi i ciklit të dytë të studimit “Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet” është hapur sipas VKM Kuotave, Nr 672, datë 14.09.2011. Me vendim Senati nr. 575, datë 01.10.2018, programi është riorganizuar nga 90 kredite në 60 kredite, dhe është miratuar me shkresë të MASR nr. 1287/1, datë 15.03.2019. Ky program mbulohet nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, në Fakultetin e Ekonomisë, i hapur në vitin 1992.

Programi i studimit “Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet” është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit. njësisë kryesore dhe bazë. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky master është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integrale, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Programi i studimit realizohet me 60 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master Profesional në Financë - Kontabilitet”.

Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në aspektet teorike, praktike dhe aplikative në fushën e shërbimeve financiare, të kontabilitetit, të auditimit, të administrimit fiskal dhe në sektorin e sigurimeve. Synimi i tij është që t’u japë të diplomuarve kualifikim dhe trajnimin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e tregut të punës për formimin e specialistëve të aftë për ushtrimin e profesionit të financierit dhe kontabilistit dhe t’u krijojë atyre një pamje të re dhe vizionare në kushtet e globalizimit dhe të integritit të Shqipërisë në BE në përputhje me standardet e kërkuara. Programi i studimit synon ta pajisë studentim me dije dhe njohuri teorike të fushës së financës dhe kontabilitetit, si dhe kompetenca dhe aftësi praktike me qëllim që studentët të jenë të aftë të ushtrorjnë profesionin e financierit dhe kontabilistit në përfundim të këtij program studimi, si në sektorin privat ashtu edhe në sektorin publik.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 26.05.2021, Universiteti "Fan S. Noli" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit "Master Profesional në Financë - Kontabilitet" nëpërmjet shërbimit në AMS. ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017" ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga universiteti, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc. Gentiana Sharku, pedagoge në FEUT, Departamenti i Financës dhe Dr. Valbona Kapllani, pedagoge në FEUT, Departamenti i Kontabilitetit. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Në datën 12.10.2021, ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas njohjes dhe vlerësimit të dosjes së vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, u hartua axhenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 8 dhe 9 nëntor në ambjentet e Universitetit "Fan S. Noli". Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 19 nëntor 2021. Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit "Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet". Në fund paraqiten disa rekomandime për institucionin mbi programin e studimit që akreditohet.

Ky raport është përpiluar në bashkëpunim mes dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 13.12.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 161 / 61 Prot, datë 13.12.2021. Universiteti "Fan S. Noli", Korçë", përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 2002/3 Prot, datë 15.12.2021, "*Kthim përgjigje, për draft raportin e vlerësimit të jashtëm*", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti “Fan Noli” (referuar në vazhdim të këtij raporti vlerësimi si “UK” është një Institucion Publik i Arsimit të Lartë i cili anagazhohet në ofrimin e programeve të studimit që nuk bien ndesh me interesat kombëtar. Veprimtaria e UK bazohet në nenin 57, pika 7, në nenin 58 të Kushtetutës, në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në parimet dhe standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore duke pasqyruar parimet dhe objektivat e procesit të Bolonjës. UK synon ofrimin e arsimit të lartë nëpërmjet zhvillimit të dijeve, shkencës dhe profesioneve, për të transmetuar njohuri në fusha dhe disiplina shkencore dhe profesionale, duke u bazuar në kërkim dhe njohuri teknologjike bashkëkohore (<i>Statuti i UK, neni 2</i>). Çdo program studimi hartohet në përputhje me standartet e parashikuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe në respektim të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve (<i>Statuti i UK, neni 47</i>), duke synuar ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. <i>[Referenca: shtojca 1.1 statuti i uk.pdf; shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar.pdf; shtojca 1.3 plani strategjik i zhvillimit; shtojca 1.3.1 draft plani strategjik i zhvillimit të uniko.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ vlerëson se programi i studimit “Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin e UK të shprehur në Statutin dhe në Rregulloren e UK, si dhe në përputhje me fushën e veprimtarisë së institucionit. Programet e studimit të ofruara nga UK synojnë të japin një kontribut në zhvillimin arsimor, ekonomik dhe të qëndrueshëm për zhvillimin e komuniteteve lokale dhe më gjerë, duke u përqëndruar në zhvillimin e aftësive profesionale dhe kërkimore, për tu përballur me kërkesat e tregut të punës. <i>[Referenca: shtojca 1.1 statuti i uk.pdf; shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar.pdf; shtojca 1.3 plani strategjik i zhvillimit; shtojca 1.3.1 draft plani</i>
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	

	<i>strategjik i zhvillimit të uniko.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit (RVB) dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se programi i studimit “Master në Financë - Kontabilitet” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit. Rregullorja e këtij program studimi përcakton qartë se ky program i ciklit të dytë synon përgatitjen e specialistëve të aftë dhe me njohuri të nevojshme për të ushtruar profesionet në fushën e financës dhe të kontabilitetit, për të punuar dhe kontribuar në zhvillimin e vendit si dhe zgjerimin e vizionit të të diplomuarve në kuadrin e globalizimit dhe integritimit europian të vendit (<i>pika 3</i>).</p> <p>GVJ vlerëson se programi i studimit është hartuar në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të UK, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë, me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit në kushtet e integritimit europian.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.3.1 draft plani strategjik i zhvillimit të uniko.pdf; shtojca 2.4 plani strategjik për zhvillimin e fe; shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit; vizita në institucion]</i></p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>GVJ vlerëson se Statuti dhe Rregulloret e UK, përcaktojnë qartë drejtimit akademike dhe konkretisht (<i>sipas nenit 2 të Statutit</i>) përcaktohet se misioni i UK është krijimi, transmetimi dhe mbrojtja e dijeve nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve në këtë fushë. Realizimi i këtij misioni bëhet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përgatitjes së specialistëve të lartë, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikave profesionale; ▪ Formimit të shkencëtarëve të rinj; ▪ Përgatitjen e individit si një qytetar të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë; ▪ Kryerjen e studimeve shkencore; ▪ Kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të lartë. <p>Në realizimin e këtij misioni, UK angazhohet për garantimin e lirisë dhe pavarësisë, në shprehjen e ideve, në kërkim, mësimdhënie dhe aktivitete të tjera universitare për të gjithë</p>

	<p>personelin dhe studentët e UK, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>[Referenca: shtojca 1.1 statuti i uk.pdf; shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit; vizita në institucion]</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit “Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet” është emërtuar, strukturuar në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të UK dhe Fakultetit Ekonomisë.</p> <p>Ky program ofrohet nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit, që në ciklin e parë të studimeve pranë FE të UK mbulon programet e studimit “Bachelor në Financë-Kontabilitet” dhe “Bachelor në Ekonomiks”, ndërsa në ciklin e dytë mbulon edhe programet e studimit “Master Profesional në Bankë dhe Sigurime” dhe “Master i Shkencave në Financë”.</p> <p>[Referenca: shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf; shtojca 2.4 plani strategjik për zhvillimin e fe; shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit; vizita në institucion]</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se programi i studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet”, është në përputhje me zhvillimet dhe interesat ekonomike të vendit si dhe të trendeve globale, për specialistë të kësaj fushe. Ky program studimi synon të përgatisë specialistë të aftë me njohuri të nevojshme në fushën e shërbimeve financiare, të kontabilitetit, të auditimit, të administrimit fiskal dhe të sektorit të sigurimeve për të punuar dhe kontribuar në zhvillimin e vendit, si dhe për të përgatitur specialistë të motivuar për të punuar në sektorin privat dhe në institucionet publike dhe strategjike të vendit.</p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.3.1 draft plani strategjik i zhvillimit të uniko.pdf; shtojca 2.4 plani strategjik për zhvillimin e fe; shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit; shtojca 3.12 studim tregu pune periodik.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.3</p> <p>Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet (<i>pika 3</i>) shpreh si objektiva të përgjithshëm të këtij program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ T’u japë të diplomuarve kualifikimin dhe trajnimin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e tregut të punës për formimin e specialistëve të aftë për ushtrimin e profesionit të financierit dhe kontabilistit; ▪ T’u krijojë atyre një pamje të re dhe vizionare në kushtet e globalizimit dhe të integritimit të Shqipërisë në BE në përputhje me standartet e kërkua; <p>Gjithashtu në rregulloren e programit të studimit (<i>pika 4</i>) përcaktohen qartë objektivat specifike të programit, dijet, njohuritë dhe aftësitë e synuara, si dhe kompetencat me të cilat pajisen studentët që të jenë të aftë të ushtrojnë profesionin e financierit dhe kontabilistit në përfundim të këtij program studimi, si në sektorin privat ashtu edhe në sektorin publik.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.4 plani strategjik për zhvillimin e fe; shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ konstatoi se Departamenti Financë-Kontabilitet ka kryer në vitin 2019 një studim për të vlerësuar zhvillimet e tregut të punës me objektivin për të vlerësuar kërkesën për specialistë të kontabilitetit dhe financës dhe për të planifikuar dhe realizuar ndryshimet e nevojshme në programin e studimit në përputhje me kërkesat e tregut.</p> <p>Gjithashtu, në takimet me drejtuesit e UK, gjatë vizitës në institucion u njoh dhe me një studim tregu të realizuar nga FE gjatë muajit mars 2021 lidhur me kërkesat e maturantëve të qarkut të Korçës për programet e studimit pranë UK.</p> <p>Përmes pyetësorëve për alumnit, Qendra e Karrierës dhe Alumnit (QKA), strukturë pranë Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional (DKVI) mbledh të dhëna dhe përgatit raporte mbi ecurinë studentëve pas diplomimit.</p> <p>GVJ vlerëson angazhimin e UK në realizimin e këtyre studimeve të tregut dhe raporteve të gjurmimit të studentëve por konstaton se kryesisht analiza në këto dokumenta është përshkruese, të dhënat në studimin e tregut për këtë PS janë të dhëna sekondare (nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata e Bankave) dhe raportet e QKA janë në nivel universiteti.</p> <p><i>GVJ rekomandon që studimi i tregut duhet të përfshijë një analizë sasiore, më të fokusuar dhe më konkrete të nevojave të tregut rajonal, por edhe me gjerë, për specialistë të fushës së financës dhe kontabilitetit dhe të mundësive të punësimit të tyre.</i></p>

	<p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 3.12 studim tregu pune-hapjeje programi studimi.pdf; shtojca 3.35 pyetësor alumni dhe relacioni për gjurmimin e studentëve.pdf; shtojca 4.3 të dhëna për gjurmimin e studenteve të diplomuar.pdf; dokument shtesë 1 studimi i tregut në shkallë fakulteti.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit të studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” (pika 3), ky program synon të zgjerojë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve; të pajisë studentët me njohuri më të thelluara në fushën e financës dhe kontabilitetit; të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale në fushën e shërbimeve financiare, të kontabilitetit, të auditimit, të administrimit fiskal dhe të sektorit të sigurimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e planit mësimor, përmbajtjes së kurikulave dhe programeve të lëndëve të programit të studimit, si dhe në bazë të opinionit të krijuar pas vizitës në institucion, GVJ arriti në përfundimin se në përgjithësi struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë në funksion të objektivave të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit dhe kompetencave të synuara për studentët e këtij program studimi. Programi i studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” zgjat 1 vit akademik dhe është organizuar me kredite të shpërndara midis lëndëve/moduleve në përputhje me VKM nr. 41. Sikurse parashikon edhe rregullorja e programit të studimit, dhe nga shqyrtimi i planit mësimor dhe programeve lëndore, GVJ konstatoi se programi i studimit, është i ngjashëm me programe që ofrohen nga institucione ndërkombëtare dhe organizimi me kredite lehtëson transferimin e studimeve apo punësimin e studentëve në tregun ndërkombëtar të punës.</p> <p>[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit; shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore të programit të PS.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disaveçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” është hartuar në bazë të Ligit të Arsimit të Lartë 80/2015, dhe aktet nënligjore përkatëse, Standardet Shtetërore të Cilësisë.</p> <p>Ky program është organizuar në kredite sipas sistemit European të Transferimit e Grumbullimit të Krediteve dhe Kartës së Bolonjës. Objektivat dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me direktivat e BE për arsimin e lartë dhe janë bazuar në praktikat më të mira të vendeve evropiane.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit,</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” përfshin realizimin e një praktike profesionale dyjavore në përfundim të semestrit të dytë.</p>

<p>si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Praktika profesionale ka për qëllim përgatitjen e studentëve për tregun e punës dhe rritjen e kualifikimit të tyre. Praktika realizohet nëpërmjet marrëveshjeve që institucioni ka nënshkruar me institucione publike dhe subjekte private, në sektorë që përputhen me objektivat dhe qëllimet e programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit; shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf; shtojca 2.13 programi i praktikës profesionale; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” nuk parashikon elemente të mësimdhënies në gjuhë të huaj.</p> <p><u>Ky program studimi është licencuar në vitin 2011</u>, fillimishit i organizuar me 90 kredite dhe më pas, në vitin 2018 është riorganizuar me 60 kredite në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit; shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p><i>[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit; shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.4</p>	
<p>Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës është Institucion i Arsimit të Lartë Publik, i krijuar në vitin 1992 mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor të themeluar në vitin 1971. Edhe Fakulteti i Ekonomisë (FE), si pjesë përbërëse e këtij Universiteti, që ofron këtë program studimi, ka filluar veprimtarinë e tij në vitin 1992. Ky fakultet përbëhet nga tre departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti i Financë-Kontabilitetit; ▪ Departamenti i Menaxhimit; ▪ Departamenti i Marketingut dhe Turizimit. <p>Departamenti i Financë-Kontabilitetit është përgjegjës për programin e studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet”. Në ciklin e parë të studimeve pranë FE, ky departament mbulon programet e studimit “Bachelor në Financë-Kontabilitet” dhe “Bachelor në Ekonomiks”, ndërsa në ciklin e dytë mbulon edhe programet e studimit “Master</p>

	<p>Profesional në Bankë dhe Sigurime” dhe “Master i Shkencave në Financë”.</p> <p>Bazur në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqëruar dhe informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka përvojë të mjaftueshme dhe cilësore për të ofruar këtë program studimi.</p> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel Departamenti përgjegjës për tre vitet e fundit përbëhet nga:</p> <table border="1" data-bbox="702 582 1396 795"> <thead> <tr> <th>PAE /Viti akademik</th> <th>2018-2019</th> <th>2019-2020</th> <th>2020-2021</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Profesor</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Profesor te Asociuar</td> <td>5</td> <td>5</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Doktor/Docent</td> <td>5</td> <td>7</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>4</td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjatë periudhës 2018 – 2021, programi i studimit është realizuar 100% me personel akademik efektiv (PAE). Bazuar në evidencat e paraqitura, GVJ konstaton se personeli akademik i këtij departamenti demonstroi se ka përvojën, kapacitetin dhe burimet e duhura në fushën akademike për të ofruar këtë program studimi.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 2.26 të dhëna për personelin akademik të departamentit.pdf; shtojca 2.25 organika e fe.p/f; shtojca 2.9 jetëshkrimet e stafit të PS.pdf; vizita në institucion]</i></p>	PAE /Viti akademik	2018-2019	2019-2020	2020-2021	Profesor	0	0	0	Profesor te Asociuar	5	5	5	Doktor/Docent	5	7	7	Msc.	4	2	2
PAE /Viti akademik	2018-2019	2019-2020	2020-2021																		
Profesor	0	0	0																		
Profesor te Asociuar	5	5	5																		
Doktor/Docent	5	7	7																		
Msc.	4	2	2																		
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Financë - Kontabilitet është program studimi i ciklit të dytë të studimeve, referuar nivelit të 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve; organizohet me 60 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje normale 1 vit akademik, në përputhje me nenin 70 pika 4 e Ligjit 80/2015. Ky është një program i fushës së shkencave ekonomike i cili ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë. Mes fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore të njësisë kryesore që është përgjegjëse për ofrimin e programit, konstatohet se ka përputhshmëri (<i>Rregullore e njësisë kryesore, neni 52</i>).</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf; shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf]</i></p>																				
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet” ofrohet nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit, i Fakultetit të Ekonomisë. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë e cila e ofron këtë program studimi.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit.pdf; shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf]</i></p>																				

programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.				
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.	Programi i studimit “Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet” ofrohet brenda drejtimit dhe fushës akademike e kërkimore së njësisë kryesore dhe njësisë bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit Financë - Kontabilitet është Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit në Fakultetin e Ekonomisë. Statuti i UK përcakton strukturat e brendshme akademike dhe administrative të institucionit. Rregullorja e njësisë kryesore, rregullorja e njësisë bazë përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të departamenti, koordinatorit të programit të studimit, personelit akademik të brendshëm, personelit akademik me kontratë të pjeshme dhe të ftuar, si dhe personelit ndihmës akademik. Aktualisht, Koordinatore e programit të studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” është Përgjegjësja e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit. I gjithë procesi i mbikëqyrjes dhe mbarëvajtjes së programit të studimit bëhet në mënyrë të koordinuar nga të gjitha njësitë e personelit në bazë të përgjegjësisë të tyre të parashikuara në rregulloret përkatëse. <i>[Referenca: shtojca 2.11 vendimi i njësisë bazë për emërimin e koordinatorëve të PS.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf]</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit “Fan S. Noli” parashikohet e drejta dhe mundësia e bashkëpunimit me institucione të tjera publike dhe private (Statuti, neni 4). Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ konstaton se aktualisht në nivel UK dhe FE janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, Fakulteti i Ekonomisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi institucionale kryesisht me

	<p>institucione publike rajonale, por jo vetëm, si dhe me sipërmarrje private.</p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.1 statuti uk.pdf; 2.10 marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave profesionale.pdf; shtojca 3.25 marrëveshje institucionale.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale mësimore në përgjithësi dhe për këtë program studimi në veçanti, në nivel fakulteti kryesisht me institucione publike rajonale dhe me disa sipërmarrje private.</p> <p>Udhëzuesi i praktikës profesionale i programit të studimit “Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet” rregullon marrëdhëniet mes studentëve, institucionit pritës për realizimin e praktikës dhe Departamentit të Financë-Kontabilitetit. Në të përcaktohen përgjegjësitë e secilës palë për realizimin e sukseshëm të praktikës profesionale.</p> <p><i>GVJ rekomandon zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimi me aktorë biznesi vendas dhe të huaj.</i></p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.1 statuti uk.pdf; 2.10 marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave profesionale.pdf; shtojca 2.13 programi i praktikës profesionale.pdf; shtojca 3.5 tabela e institucioneve bashkëpunuese për praktikat.pdf; shtojca 3.25 marrëveshje institucionale.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, pranë Universitetit “Fan S. Noli” funksionon Qendra e Inovacionit e krijuar në vitin 2018 në kuadër të projektit “Innovation Eco-System in the CBC area” dhe në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar disa trajnime me studentë aktivë dhe të diplomuar. Në planin strategjik të zhvillimit të UK, përcaktohet se kjo qendër angazhohet sëbashku me strukturat e tjera të institucionit në mbështetjen e të rinjve drejt sipërmarrjes.</p> <p><i>Megjithatë GVJ konstaton se mungon informacioni lidhur me natyrën specifike të këtyre trainimeve dhe lidhjen e tyre me programin e studimit objekt vlerësimi.</i></p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.3.1 draft plani strategjik i zhvillimit.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, pranë Universitetit “Fan S. Noli” funksionon Qendra e Inovacionit e krijuar në vitin 2018 në kuadër të projektit “Innovation Eco-System in the CBC area” dhe në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar disa trajnime me studentë aktivë dhe të diplomuar. Në planin strategjik të zhvillimit të UK, përcaktohet se kjo qendër angazhohet sëbashku me strukturat e tjera të institucionit në mbështetjen e të rinjve drejt sipërmarrjes.</p> <p><i>Megjithatë GVJ konstaton se mungon informacioni lidhur me natyrën specifike të këtyre trainimeve dhe lidhjen e tyre me programin e studimit objekt vlerësimi.</i></p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.3.1 draft plani strategjik i zhvillimit.pdf]</p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës institucion, GVJ konstatoi se në mbledhjet e departamentit të Financë-Kontabilitetit, analizohen rezultatet e marrëveshjeve të bashkëpunimit kryesisht për realizimin e praktikave profesionale si pjesë e analizës vjetore të departamentit por nuk ka një raport analitik të përfitimeve nga ky bashkëpunim. Relacioni përkatës, i paraqitur si pjesë e dokumentacionit</p>

	<p>shoqërues të RVB, është shumë i përgjithshëm, më shumë përshkruar, mungojnë të dhëna mbi institucionet ku është kryer praktika profesionale, përfitimet apo problemet specifike që studentët kanë ndeshur gjatë zhvillimit të praktikave etj.</p> <p><i>GVJ rekomandon hartimin e raporteve analitike dhe më të plota, të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.6 raport i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit.pdf]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” është hapur me VKM, Nr. 672, datë 14.09.2011. Me vendimin Nr. 575, datë 01.10.2018, të Senatit Akademik të UK dhe me miratimin nga MASR me shkresën Nr. 1287/1 prot, datë 15.03.2019, programi është riorganizuar nga 90 kredite në 60 kredite (ECTS). Ky program i ciklit të dytë të studimeve ofrohet me kohë të plotë, gjatë një viti akademik (i organizuar në dy semestra) dhe në gjuhën shqipe. Programi i studimit “Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet” është i organizuar në lëndë që vlerësohen në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse. Kurrikula e programit të studimit përmban 10 (dhjetë) lëndë të detyrueshme dhe 1 (një) lëndë me zgjedhje, praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf; shtojca 2.7 plani mësimor.pdf; shtojca 3.30 kurrikula master profesional në financë-kontabilitet.pdf]</i></p>
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një	Programi i studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” synon të përgatisë specialistë të aftë me njohuri të nevojshme në

llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	fushën e shërbimeve financiare, të kontabilitetit, auditimit, administrimit fiskal, sektorit të sigurimeve etj.
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Bazuar në informacionin e RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, GVJ konstaton se ky program studimi ofron për studentët mbulim të hollësishëm të teorisë dhe njohurive teknike, nxit të menduarin kritik si edhe përgatit profesionistë me ndërthurje të njohurive akademike dhe praktike të fushës së financës dhe kontabilitetit.
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Lëndët karakterizuese dhe ndërdisiplinore përfshijnë lëndë si: “Kontabiliteti i Kostos & Drejtimit i Avancuar”; “Drejtimi Financiar i Organizatave Publike” dhe “Drejtimi Financiar Ndërkombëtar”; “Analiza e Investimeve & Menaxhimi i Portofolit”; “Auditimi”; si dhe “Drejtimi i Sigurimeve”, duke mbuluar thuajse të gjithë sektorët dhe aktorët më të rëndësishëm të ekonomisë. Gjithashtu, nga shqyrtimi i planit mësimor dhe programeve të lëndëve dhe informacionit të marrë në takimet me pedagogët dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se në tërësi lëndët e ofruara në këtë program studimi si edhe përmbajtja e programeve të tyre mundësojnë ndërthurjen dhe integrimin e njohurive në mënyrë të tillë që, nga ana teknike, e aftësojnë studentin të përgatitet për zgjidhjen problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën specifike të programit të studimit. <i>[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore të PS.pdf; shtojca 3.30 kurrikula master profesional.pdf; vizita ne institucion]</i>
Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” përmban të gjithë elementët e nevojshëm të strukturës së një program studimi sipas kuadrit rregullator në fuqi si: kurrikula dhe plani mësimor; programet e lëndëve; dhe rregulloren e programit të studimit.
Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Në planin mësimor të programit të studimit është përcaktuar qartë klasifikimi i lëndëve dhe vlerësimi i tyre me kredite sipas tipologjisë së përcaktuar në VKM nr.41: <ul style="list-style-type: none"> ▪ 1 (një) lëndë e kategorisë bazë me 8,3% kredite ndaj totalit të krediteve; ▪ 5 (pesë) lëndë të kategorisë kategorizuese me 40% kredite ndaj totalit të krediteve; ▪ 4 (kater) lëndë të kategorisë ndërdisiplinore me 31,7% kredite ndaj totalit të krediteve; ▪ 2 (dy) lëndë të kategorisë plotësuese me 10% kredite ndaj totalit të krediteve; ▪ Detyrime përmbyllëse me 10% kredite ndaj totalit të krediteve. Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese janë përlllogaritur duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në

	<p>auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku përfshihen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime/projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p>GVJ konstaton se përveç krediteve të lëndëve ndërdisiplinore që e tejkalojnë pak maksimumin e lejuar me VKM nr.41, kategoritë e tjera të lëndëve janë brenda kufijve të parashikuar në VKM nr. 41.</p> <p><i>GVJ sugjeron rishikimin e rregullores së programit të studimit pasi në disa pjesë të saj përcaktimet janë të përgjithshme dhe/ose përmbajnë gabime, të cilat lënë hapësirë për interpretime të dyfishta.</i></p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf; shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore të ps.pdf; shtojca 3.30 kurrikula e ps.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>GVJ konstatoi se aktualisht plani mësimor i programit të studimit përcakton 2 (dy) kredite për praktikën profesionale që, sipas parashikimit në program, zhvillohet dy javët e fundit të semestrit të dytë. Në takimin me stafin akademik të programit të studimit kjo zgjedhje u argumentua me faktin se kuadri rregullator për programin e ciklit të dytë Master Profesional (niveli 7-të i KSHK-së) ka lënë pak hapësirë për kredite për lëndët e kategorisë D, ku përfshihet praktika profesionale (deri në 10% të totalit të krediteve të programit, pra maksimumi 6 kredite). Ndërkohë në kategorinë D, programi i studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” përfshin edhe lëndën “Kontabilitet Aplikativ”.</p> <p>GVJ gjykon se praktika mësimore dy javore me 2 (dy) kredite është e pamjaftueshme për të pajisur studentët e një programi master me njohuri praktike të nevojshme për të hyrë në tregun e punës apo për të rritur mundësitë e studentëve për ndërtimin e një karriere të sukseshme.</p> <p><i>GVJ rekomandon se praktika profesionale duhet të ketë një kohëzgjatje nga 4 deri në 6 javë, e të vlerësohet me më shumë kredite, si dhe të rishihet klasifikimi sipas kategorive i disa lëndëve si psh i lëndës “Kontabilitet Aplikativ” në gjykimin tonë lëndë me karakter ndërdisiplinor/integrues.</i></p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore të ps.pdf; shtojca 2.13 programi i praktikës profesionale.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit është Fakulteti i Ekonomisë (FE), i cili e ka filluar aktivitetin e tij si pjesë përbërëse e Universitetit “Fan S. Noli” në vitin 1992. Programi i studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” është liçensuar në vitin 2011 me VKM Nr. 565 dhe është riorganizuar nga program me 90 kredite në program me 60 kredite me vendimin e Senatit nr. 575, të datës 1.10.2018. Fakulteti i Ekonomisë është një nga katër Fakultetet e Universitetit “Fan S. Noli” (UK) i cili ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit të zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 65, datë 21.09.2017 për akreditimin institucional të UK, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 30.09.2022. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Financë-Kontabilitetit i cili së bashku me dy departamentet e tjera të këtij Fakulteti, përbëjnë njësinë bazë të zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore dhe shkencore në FE.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.4 plani strategjik për zhvillimin e fe.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, rezulton se Fakulteti i Ekonomisë, si njësi kryesore e programit të studimit, është i organizuar në tre njësi bazë në përputhje me nenin nr. 23 të Ligjit nr. 80/2015:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti Financë-Kontabilitet; ▪ Departamenti i Mnxhimit; dhe ▪ Departamenti Marketing-Turizëm.
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë në vitin akademik 2020 - 2021, ka në përbërje të tij 36 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 34 janë staf akademik efektiv (PAE), dhe 2 staf akademik me kontratë, (PAK).</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2020-2021:</p> <p><u>Departamenti Financë-Kontabilitet;</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 14 PAE, ndër të cilët 12 me tituj / grada; - 1 PAK, me gradë; <p><u>Departamenti i Menaxhimit;</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 PAE, ndër të cilët 9 me tituj / grada;

- 1 PAK

Departamenti Marketing-Turizëm;

- 10 PAE, ndër të cilët 9 me tituj / grada;

- 0 PAK;

Struktura e FE dhe e Departamentit të Financë-Kontabilitetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tyre përcaktohen në Statutin e UK dhe Rregulloret përkatëse në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi. Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë dhe Rregullorja e Departamentit të Financë-Kontabilitetit rregullojnë organizimin dhe strukturën e njësive përkatëse bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe në Statutin dhe Rregulloren e UK.

GVJ konstaton se pedagogët e angazhuar pranë Departamentit të Financë-Kontabilitetit plotësojnë kushtet e kërkuara nga Ligji i arsimit të Lartë për të dhënë mësim në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Personeli Akademik i Departamentit të Financë-Kontabilitetit për tre vitet e fundit përbëhet nga:

Gradat/Titujt/	2018-2019		2019-2020		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.Assoc	5	-	5	-	5	-
Dr	5	-	7	-	7	1
MSc	4	1	2	-	2	-
	14	1	14	-	14	1
Total	15		14		15	

Gjatë periudhës 2018 – 2021, programi i studimit është realizuar 100% me personel akademik të angazhuar me kohë të plotë pranë FE.

Për sa i përket kualifikimeve të PA të Departamentit të Financë-Kontabilitetit :


- Për 2018-2019, 67% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 33% janë Msc;
- Për 2019-2020, 86% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 14% janë Msc;

	<p>- Për 2020-2021, 87% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 13% janë Msc;</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.1 statuti uk.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf; shtojca 2.26 të dhëna për personelin akademik të departamentit PS.pdf; shtojca 2.25 organika e fe.pdf]</i> Tabelat permbledhese per Aneks_RVB_feko.docx</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Departamenti i Finance-Kontabilitetit ka angazhuar 1 (një) personel ndihmës akademik (sekretar departamenti) përveç personelit ndihmës akademik të angazhuar nga Fakulteti i Ekonomisë, të cilët ndihmojnë në zhvillimin e programit të studimit dhe realizimin e praktikave mësimore.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.25 organika e fe.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Departamenti i Financë-Kontabilitetit me Vendim Nr. 343 datë 27.06.2019 ka emëruar koordinator të programit të studimit, përgjegjësen e departamentit të Financë-Kontabilitetit.</p> <p>Detyrat e koordinatorit të programit të studimit, si përgjegjës për zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, përcaktohen në (nenin nr. 10), të rregullores së Departamentit të Financë-Kontabilitetit. Koordinatori i programit të studimit është njëkohësisht edhe përgjegjës për ndjekjen e praktikave profesionale.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.11 vendimi i njësisë bazë për emërimin e koordinatorëve të PS.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X
<p>Standardi II.3</p> <p>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</p>				
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>			
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, dokumentacionin shoqëruar dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit që janë përgjegjës për programin e studimit, disponojnë informacionin e duhur për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi.</p>			
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit është organizuar në përputhje me specifikimet ligjore. Konkretisht, programi i studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” është i</p>			

<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>organizuar në 13 lëndë, përfshirë edhe praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, të vlerësuara me kredite dhe të organizuara sipas tipit të disiplinës që ofrojnë, në përputhje me VKM nr. 41.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Kohëzgjatja e programit të studimit është 1 (një) vit, i organizuar në dy semestra. Të gjitha lëndët janë të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semester përmban 15 jave mësimore dhe 30 kredite. Gjatë semestrit të parë zhvillohen 6 lëndë dhe në semestrin e dytë zhvillohen 5 lëndë, praktika profesionale dhe detyrimet përmbyllëse (diploma).</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” përmban informacion mbi vlerësimin e lëndëve me kredite, semestrin kur zhvillohet secila lëndë dhe ngarkesën mësimore në orë brenda dhe jashtë auditorit për secilën lëndë. Në këtë plan, ngarkesa e programit me 60 kredite është llogaritur 1.500 orë, (60 ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat rreth 58% përfaqësojnë orë jashtë auditorit.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit dhe programet e lëndëve (syllabuset) përmbajnë informacion edhe mbi rregullat e frekuentimit/ndjekjes së programit të studimit, mënyrën e vlerësimit të njohurive nga studentët, metodat e mësimdhënies etj. Aktualisht vlerësimi i njohurive të studentëve në këtë program studimi parashikohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 30% të vlerësimit nga aktivizimi dhe kontrollet e vijueshme (teste/detyra kursi); - 70% të vlerësimit me provim me shkrim në fund të semestrit; <p>Gjithashtu pranë këtij program studimi aplikohet detyrimi i frekuentimit në masën 75% të veprimtarive mësimore të parashikuara.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf; shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore të PS.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e programi të studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” përmban informacionin lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. GVJ konstaton se këto kriteret janë përgjithësisht në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të UK.</p> <p>Por siç u përmend edhe më lart, në kriteret 5 & 6 të Standardit II.1, <i>GVJ sugjeron rishikimin e rregullores së këtij programi</i></p>


	<p><i>studimi pasi në disa pjesë të saj përcaktimet janë të përgjithshme dhe/ose përmbajnë gabime, të cilat lënë hapësirë për interpretime të dyfishta. Psh. fjala “etj” në fund të kriterëve për pranim (pika 8) jep mundësinë e pranimeve në mënyrë “arbitrare” të studentëve që mund të mos kenë parapërgatitjen e nevojshme për të ndjekur këtë program studimi ose komenti në kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve (pika 16) duhet rishikuar sepse ky program studimi e ka kohëzgjatjen një vit.</i></p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit dhe programet e çdo lënde (syllabuset) janë hartuar në bazë të kërkesave dhe formatit të akteve ligjore dhe nënligjore. Ato përmbajnë informacionin e domosdoshëm për zhvillimin e një lënde: ngarkesën mësimore, semestrin kur zhvillohet, konceptet themelore të lëndës, temat që zhvillohen çdo javë, rregullat e frekuentimit dhe vlerësimit të dijeve në lëndë, literaturën bazë dhe atë indihmëse etj.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.8 programet lëndore të PS.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe aprovohet dosja e plotë.</p>	<p>Në takimin me stafin akademik, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në fillim të çdo viti akademik, në mbledhjen e Departamentit të Financë-Kontabilitetit diskutohet për çdo ndryshim apo përmirësim të mundshëm të programit të studimit dhe më pas vijohet me miratim e programeve sipas lëndëve. Në tri vitet e fundit, programi i studimit “Master në Financë dhe Kontabilitet” nuk ka patur ndryshime të lëndëve, por vetëm ka im të lëndëve nga një semetër në semestrin tjetër.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.15 dokument për ndryshimet në PS.pdf]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.4</p> <p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” realizohet me 60 kredite dhe me kohëzgjatje 1 (një) vit akademik, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, neni 75, pika 6.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” përmban lëndë të tipit bazë, karakterizuese,</p>


 21

<p>lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>ndërdisciplinor/integruese dhe plotësuese si dhe praktikën profesionale. Objektivat e paraqitura në programet përkatëse të lëndëve kanë për qëllim të mundësojnë thellimin e njohurive në fushën e finances dhe kontabilitetit dhe përgatitjen e studentëve me aftësi dhe kompetencat e nevojshme për të hyrë në tregun e punës.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore të PS.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimit profesional.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet”, parashikon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 6 (gjashtë) lëndë gjatë semestrit të parë; - 5 (pesë) lëndë që zhvillohen semestrin e dytë, praktikën profesionale që zhvillohet gjatë dy javëve të fundit të semestrit të dytë dhe në mbyllje tezën e diplomës; <p>Secila lëndë është vlerësuar me kredite dhe orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, 7 (shtatë) lëndë (pavarësisht tipologjisë) janë vlerësuar me 125 orë mësimore (60 orë mësimore në auditor dhe 65 orë mësimore jashtë auditorit), 3 (tre) lëndë janë vlerësuar me 100 orë mësimore (50 orë në auditor dhe 50 orë jashtë auditorit), praktika profesionale zhvillohet me 50 orë jashtë auditorit, ndërsa për punimin e tezës së diplomës janë parashikuar 150 orë mësimore.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, dokumentacion shoqërues dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se struktura e programit të studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” në përgjithësi përputhet me profilin e programit master dhe është e përafërt me programe studimi ndërkombëtare.</p> <p>GVJ konstatoi se plani mësimor përmban dy lëndë “Financa Ndërkombëtare” dhe “Drejtimit Financiar Ndërkombëtar” që studiojnë të njëjtën degë të financës dhe kanë për qëllim përgatitjen e specialistëve në të njëjtin profil, por që nuk përshtaten shumë me profilin profesional të këtij programi studimi dhe tregun kryesor të synuar të punësimit të të diplomuarve. Ndërkohë bie në sy mungesa e një lëndë të mirëfilltë që të japë aftësi dhe kompetenca në sektorin bankar - një sektor i cili edhe sipas studimit të tregut të kryer për këtë program studimi, pritet të punësojë një pjesë të mirë të të diplomuarve.</p> <p>Gjithashtu, në këtë program studimi praktika profesionale parashikohet të zhvillohet dy javë. Siç u përmend edhe më lart, në kriterin 7 të Standardit II.1, GVJ e vlerëson si të pamjaftueshme këtë kohëzgjatje në kuadrin e një masteri</p>

22



	<p>profesional, për pajisjen me njohuri praktike të nevojshme për të hyrë në tregun e punës apo për të rritur mundësitë e studentëve për ndërtimin e një kariere të sukseshme</p> <p><i>GVJ rekomandon rishikimin e strukturës së programit të studimit përsa i takon kohëzgjatjes së praktikës profesionale dhe përfshirjes së një lënde nga sektori bankar, si dhe rishpërndarjes së krediteve pas rishikimit, në mënyrë që studentët të fitojnë kompetenca të plota teorike dhe praktike për të qenë të aftë në tregun e punës, si dhe raporti teori praktikë i programit të jetë sa më në përputhje me profilin master profesional.</i></p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore të PS.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet ofron formim teorik dhe njëkohësisht aftësi praktike në përgjithësi në fushën e financës dhe kontabilitetit dhe në veçanti në fushën e auditimit, fiskaliteteve, sigurimeve dhe financave ndërkonbëtare. Objektivat formuese të secilës lëndë janë të formuluar në mënyrë të qartë tek syllabuset përkatëse. Rregullorja e programit të studimit (pika 16) rregullon mënyrën e transferimit të studimeve. Por siç u përmend edhe më lart, në kriteret 5 & 6 të Standardit II.1, GVJ sugjeron rishikimin e rregullores së këtij programi studimi pasi në disa pjesë të saj përcaktimet janë të përgjithshme dhe/ose përmbajnë gabime, të cilat lënë hapësirë për interpretime të dyfishta.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UV, rezultoi se programet e lëndëve përditësohen për të reflektuar ndryshimet në mjedisin ekonomike, eksperiencat më të mira ndërkombëtare dhe nevojat e studentëve.</p> <p>Përditësimet dhe ndryshimet në programet lëndore miratohen çdo vit fillim viti akademik, në mbledhjen e departamentit. Literatura e çdo lënde, si literaturë e detyrueshme, ashtu edhe ajo e rekomanduar, janë pjesë e syllabusit të lëndës. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin e stafit akademik për tu ofruar studentëve informacion sa më aktual dhe praktik, pavarësisht se literatura në programet e lëndëve nuk është e pesë viteve të fundit.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.8 programet lëndore të PS.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” në përgjithësi mundëson përfundimin e dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve, të kompetencave</p>

programet e studimit të ciklit të dytë.	teknike të synuara për një program të masterit profesional në fushën financës dhe kontabilitetit.			
Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Gjithashtu, nga shqyrtimi i planit mësimor dhe programeve lëndore të këtij programi, GVJ konstatoi se në përgjithësi programi siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. Përsa i përket aftësive teknike në profesion, programet e lëndëve të këtij programi studimi paraqiten kryesisht të kompletuara, megjithatë <i>GVJ gjykon se disa prej tyre kanë nevojë për rishikim dhe sugjeron që elementëve praktikë t'u jepet një rëndësi më e madhe, sikurse u komentua edhe në kriterin nr. 4.</i> <i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore të PS.pdf]</i>			
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet” mundëson kryesisht punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit synon përgatitjen e specialistëve të fushës si në sektorin privat dhe në atë publik dhe megjithëse në objektivat e tij nuk synon vijimin e mëtejshëm të studimeve, aftëson studentët të ndjekin edhe kualifikime më të thelluara profesionale. <i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor i PS.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf]</i>			
Shkalla e përmbijshjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit “Master profesional në Financë - Kontabilitet” përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Për këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej 11 anëtarë të personelit akademik (PAE), të gjithë personel akademik me kohë të plotë. Pra mbulimi i këtij program studimi bëhet 100% nga PAE. <i>[Referenca: shtojca 1.4 rregullorja e drejtorisë së burimeve njerëzore.pdf; shtojca 1.14 udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit uk.pdf; shtojca 4.1 tabela përmbledhëse për PS.pdf; shtojca 2.9 jetëshkrimet e stafit akademik të PS.pdf]</i>

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit zotëron nivelin e duhur të kualifikimit akademik për të realizuar lëndët dhe modulet e këtij program studimi.

Numri dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në këtë program studimi për tre vitet e fundit paraqitet si vijon:

PAE /Viti akademik	2018-2019	2019-2020	2020-2021
Profesor	0	0	0
Profesor te Asociuar	5	5	5
Doktor/Docent	5	6	6
Msc.	1	0	0

Përveç vitit akademik 2018-1019, ku nga 11 anëtare të personelit akademik të angazhuar një anëtar kishte kualifikimin akademik MSC gjatë dy viteve pasuese, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka të paktën gradën shkencore doktor, sipas kërkesave ligjore për mësimdhënie në një program studimi master.

Gjatë periudhës 2018 – 2021, programi i studimit është realizuar 100% me personel akademik efektiv (PAE) pranë FE.

Në të tre vitet e fundit akademike vihet re një qëndrueshmëri e stafit mësimdhënës në këtë program studimi.

[Referenca: shtojca 1.4 rregullorja e drejtorisë së burimeve njerëzore.pdf; shtojca 1.14 udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit uk.pdf; shtojca 4.1 tabela përmbledhëse për PS.pdf; shtojca 2.9 jetëshkrimet e stafit akademik të PS.pdf]

Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Nga shqyrtimi i CV të stafit akademik, GVJ konstatoi se pedagogët që janë të angazhuar në lëndë të këtij programi mësimor kanë arsimimin dhe formimin në fushëm e ekonomisë dhe kane kryer kualifikime shkencore të mëtjshme në këtë drejtim. Stafi akademik ka marrë pjesë vazhdimisht në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ka botuar artikuj në revista shkencore, duke rritur kulifikimin e tij shkencor në përputhje me programin e studimit.

GVJ konstatoi se programi i studimit mbulohet tërësisht nga staf i brendshëm akademik.

GVJ sugjeron që të shihet mundësia e përfshirjes edhe të ekspertëve të jashtëm të fushës të cilët do të ndihmonin në rritjen e aftësisë praktike të studentëve.

[Referenca: shtojca 2.9 jetëshkrimet e stafit akademik të PS.pdf]

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë

Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione private dhe publike për realizimin e praktikës profesionale. Përveç pedagogut udhëheqës së praktikës, studenti mbikqyret edhe nga një punonjës i autorizuar i institucionit ku zhvillon

<p>në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>praktikën, i cili asiston mbikqyr dhe vlerëson studentin në përfundim të kryerjes së praktikës. Ky vlerësim merret në konsideratë për vlerësimin përfundimtar me notë të studentit për kryerjes e praktikës profesionale.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.25 marrëveshje institucionale.pdf; shtojca 2.10 marrëveshje bashkëpunimi të praktikave.pdf; shtojca 2.29 komisionet e mbikqyrjes së praktikave.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka një personel ndihmës akademik, ndërsa Fakulteti i Ekonomisë në organikën e tij nuk ka ndonjë punonjës ndihmës akademik për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore.</p> <p>Pavarësisht se plani mësimor i programit të studimit “Master Profesional në Financë - Kontabilitet“ nuk parashikon orë laboratorike, ai përban një lëndë e cila zhvillohet nëpërmjet përdorimit të pajisjeve kompjuterike.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.25 organika e fe.pdf; shtojca 2.7 plani mësimor.pdf]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Në takimet gjatë vizitës në institucion GVJ mori konfirmimin që strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin në konsideratë sugjerimet e partnerëve nga tregu i punës.</p> <p>Megjithatë GVJ nuk ka konstatuar ndonjë ndryshim apo përmirësim të programit si rezultat i këtyre propozimeve dhe nuk ka në dispozicion ndonjë evidencë të propozimeve të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës përveç relacionit mbi organizimin e tavolinës së rrumbullakët nga njësia bazë.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.21 tryeza e rrumbullakët organizuar nga departamenti.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimin të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezultoi se Departamenti i Financë-Kontabilitetit, zhvillon mbledhje ku stafi akademik diskuton lidhur me ndryshimet e mundshme të programit të studimit, me qëllim përmirësimin e tij. Në përfundim të semesterit, studentëve u shpërndahet edhe një pyetësor,</p>

	<p>nëpërmjet të cilit merren mendime dhe opinione të studentëve mbi përmirësimin e programit të lëndës.</p> <p>GVJ i është vënë në dispozicion formulari i pyetësorit, si edhe një analizë nga pedagogu në përfundim të modulit, por konstaton se nuk ka ndonjë raport statistikor apo një analizë të problemeve dhe propozimeve që rezultojnë nga plotësimi i pyetësorëve të studentëve.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.17 model analiza në përfundim të një moduli.pdf; shtojca 3.13 pyetësor studentor fund kursi.pdf; vizita ne institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>Në bazë të Statutit dhe Rregullores së UK, në vitin 2012 institucioni ka ngritur Qendrën e Karrierës dhe Alumnit (QKA). Një nga funksionet e qendrës është t'u ofrojë shërbime të diplomuarve, gjurmimi i studentëve të diplomuar dhe mbajtja e kontakteve me ta për të qenë më afër tregut të punës.</p> <p>GVJ konstaton se gjatë vitit 2019-2020, QKA ka zhvilluar një pyetësor mbi gjurmimin e studentëve të diplomuar dhe ka hartuar edhe një analizë vjetore mbi aktivitetet e kryera gjatë këtij viti akademik, ku janë evidentuar edhe problematikat lidhur me këtë çështje.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.20 analiza vjetore QKA.pdf; shtojca 3.35 pyetësor alumni dhe relacion mbi gjurmimin e studentëve të diplomuar.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj. institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokun entacionit shoqëruar dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezultoi se Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka organizuar leksione/seminare të hapura për studentët me ekspertë të fushës. Megjithatë GVJ nuk konstatoi ndonjë evidencë konkrete mbi pjesëmarrjen dhe mendimet që kanë shprehur këta bashkëpunëtorë dhe partnerë nga tregu i punës përveç relacionit mbi organizimin e tavolinës së rrumbullakët nga njësi bazë.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.21 tryeza e rrumbullakët e organizuar nga departamenti.pdf; vizita ne institucion]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se rregullorja e institucionit ka udhëzues mbi elementët e mësimdhënies si në auditor (leksione, seminare, ushtrime, lëndë speciale, laboratorë, proekte kursi) edhe jashtë auditorit (praktikë profesionale, konsultime, punë individuale etj.). Rregullorja e njësisë kryesore kërkon që elementët e mësimdhënies të parashikohen në planet mësimore, programet e moduleve dhe rregulloren e programit të studimit. Nga shqyrtimi i këtyre dokumentave, GVJ konstatoi se ato i përmbanin format e mësimi praktik dhe teorik të lëndëve të programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.2 rregullore e uniko.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.7 plani mësimor.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf.]</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, GVJ konstatoi se institucioni ka përgatitur dhe përdor një kuadër të plotë rregullator për garantimin e cilësisë ku përfshihen “Manuali i cilësisë” dhe “Rregulloret përkatëse” në të gjitha nivelet e organizimit të institucionit. Konkretisht rregullorja e njësisë kryesore, përgjegjëse e programit të studimit, përfshin mekanizma monitorimi dhe vlerësimi të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi i pedagogut nga përgjegjësi i departamentit, i cili ka detyrën të ushtrojë kontroll mbi veprimtarinë mësimdhënëse të anëtarëve të departamentit; ▪ Vlerësimi i pedagogut dhe i lëndës nga studentët, i cili kryhet nëpërmjet pyetësorit në fund të çdo semestri, për çdo lëndë dhe çdo pedagog. ▪ Vetvlerësimi, i cili realizohet nga një pyetësor dhe një raport i pedagogut mbi ecurinë dhe problematikat e proçesit mësimor. <p>Gjithashtu pjesë e detyrave të Sektorit të Kurrikulës, Vlerësimi Institucional dhe Alumni, strukturë pranë Drejtorisë së Kurrikulave dhe Vlerësimi Institucional, është edhe monitorimi i cilësisë së mësimdhënies, pavarësisht se GVJ nuk</p>

	<p>konstatoi ndonjë raport vlerësimi të mirëfilltë të punës së stafit akademik.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.5 rregullore e drejtorisë së kurrikulave.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 3.13 pyetsor studentor fund kursi.pdf; shtojca 3.14 pyetësor i stafit akademik.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në takimin me studentët e këtij program studimi, GVJ mori konfirmimin se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve nëpërmjet plotësimit të pyetësorit në fund të semestrit.</p> <p>Gjithashtu sekretaria mësimore dhe koordinatori i programit të studimit shërbejnë si pika të kontaktit të vazhdueshëm me studentët për problematikat dhe ankesat që shfaqin këta të fundit dhe përcjelljen e tyre pranë stafit akademik të Departamentit të Financë-Kontabilitetit.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf; shtojca 3.13 pyetsor studentor fund kursi.pdf; vizita ne institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie në nivel institucioni dhe në nivel fakulteti pasi përpunojnë rezultatet e vlerësimit ia komunikojnë ato autoriteteve drejtuese, përkatësisht Senatit Akademik dhe Dekanit. Anëtarëve të personelit akademik iu komunikohen përfundimet nga Përgjegjësi i Departamentit në raportet vjetore të veprimtarisë së Departamentit.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.7 raportet vjetore të njsbc.pdf; shtojca 3.9 analizë vjetore e e veprimtarisë së njësisë kryesore.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacione e paraqitur në RVB dhe informacione marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson angazhimin e departamentit të Financë-Kontabilitetit në përdorimin e analizave periodike e punës, në nxitjen dhe promovimin e shembujve të praktikave të mira në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies, kurrikulës, planit mësimor dhe programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.9 analizë vjetore e e veprimtarisë së njësisë kryesore.pdf; vizita ne institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Plani mësimor dhe programet lëndore të programit të studimit “Master në Financë - Kontabilitet“ përmbajnë si forma mësimdhënie dhe të transmetimit të dijeve: leksionet, seminarët, detyrat dhe projekte të kursit, praktika profesionale në përputhje me format e mësimdhënies të miratuara nga UK dhe Fakulteti i Ekonomisë.</p> <p>Plani mësimor parashikon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - semestri i parë 360 orë në auditor (270 orë leksioni, 90 orë seminari) / 390 orë jashtë auditorit; - semestri i dytë 270 orë në auditor (165 orë leksioni, 105 orë seminari) / 480 orë jashtë auditorit; - Totali 1500 orë <p><i>[Referenca: shtojca 1.2 rregullore e uniko.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.7 plani mësimor.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore të PS.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Në përputhje me rregulloren e programit të studimit, format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore dhe programet lëndore (syllabuset). Nga vizita në institucion GVJ mori konfirmimin se personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta, pa diskriminim, për të gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike.</p> <p>Në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies, përveç atyre klasike si referimet me gojë të studentëve, detyra të shkurttra me shkrim (ese), projekte studimi në grup për të nxitur bashkëpunimin mes palëve në kushte simuluese të punës, si dhe për të përmirësuar programin në bazë të reagimeve dhe opinioneve të studentëve.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.8 programet lëndore të PS.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Sipas RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se Universiteti “Fan S. Noli” dhe Fakulteti i Ekonomisë mbështesin vazhdimisht personelin akademik për plotësimin dhe përmirësimin e kompetencave didaktike nëpërmjet trainimeve të stafit akademik, leksioneve të hapura, diskutimeve gjatë mbledhjeve dhe analizave vjetore të departamentit etj.</p> <p>Për shkak të problematikave të shkaktuara nga pandemia Covid-19, dy vitet e fundit trajnimet kryesisht u referohen përdorimit platformave on-line të organizimit të mësimit dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.32 trainim i stafit për platformën ucris.pdf; shtojca 3.8 analiza vjetore e njësisë bazë.pdf; vizita ne institucion]</i></p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe jetëshkrimeve të personelit akademik, GVJ konstatoi se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie ka kualifikimin dhe kompetencat e duhura për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Gjatë vizitës në institucion, personeli akademik konfirmoi se gjatë procesit mësimor përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies, duke kombinuar metodat tradicionale me ato bashkëkohore.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.32 programet e studimit.pdf; shtojca 2.9 jetëshkrimet e stafit të PS.pdf; vizita ne institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Bazuar në informacion e paraqitur në RVB dhe informacion e marrë në takimet gjatë vizitës në UK, GVJ vlerëson angazhimin e institucionit për të tërhequr opinionet dhe ragimet e studentëve për përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies. Kjo realizohet nëpërmjet pyetësorëve të realizuar në fund të çdo semestri si dhe nëpërmjet raporteve të vetvlerësimit të hartuara nga personeli akademik në përfundim të çdo moduli apo lënde.</p> <p>Megjithatë u konstatua se pjesëmarrja e studentëve në pyetësorët e fundit të semestrit ishte e ulët prandaj, <i>GVJ rekomandon përdorimin e instrumentave alternativë si kombinimi i shërbimeve që u ofrohen studentëve përmes platformave online për të nxitur pjesëmarrjen e tyre në këtë proces.</i></p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.13 pyetësori studentor në fund të kursit.pdf; shtojca 3.8 analiza vjetore e njësisë bazë.pdf]</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Bazuar në informacioni e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UK, rezulton se plani mësimor dhe programet lëndore të këtij programi studimi parashikojnë forma dhe metoda interaktive të mësimdhënies, si diskutime, projekte dhe detyra kursi, punime individuale ose ne grup, të cilat inkurajojnë punën e pavarur dhe në grup të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Studenti, që në fillim të zhvillimit të lëndës, njihet me mënyrën e vlerësimit të dijeve, pikët për vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar. Gjatë procesit mësimor, stafi akademik inkurajon debatet dhe diskutimet e studentëve në orët e leksionit dhe seminareve si dhe ndjek nga afër ecurinë e tyre në këtë program studimi. Gjithashtu, gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi marrëdhënie respekti të ndërsjellë mes stafit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore të PS.pdf]</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve														
<p>Kriteri 1. Proçesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet me drejtuesit dhe stafin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi se programi i studimit “Master Profesional në Financë-Kontabilitet” i zhvillon aktivitetet mësimore në godinën e Fakultetit të Ekonomisë të UK. Aktualisht kjo godinë është në proçes rikonstruksioni të përgjithshëm të infrastrukturës për t’u garantuar studentëve dhe pedagogëve kushte sa më të përshtatshme për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore.</p> <p>Të dhënat në vijim i referohen përmbledhtas mjediseve kryesore në dispozicion të studentëve dhe personelit pranë FE të UK:</p> <table border="1" data-bbox="715 947 1374 1245"> <thead> <tr> <th>Mjedisi</th> <th>Nr. Sallash</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla leksioni</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>Salla seminari</td> <td>15</td> </tr> <tr> <td>Laborator informatike/lëndësh</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Zyra për stafin akademik</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>Bibliotekë / Internet</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Ambiente ndihmëse (fotokopje/zyra info/ të tjera ndihmëse)</td> <td>5</td> </tr> </tbody> </table> <p>Sipërfaqja për student në Fakultetin e Ekonomisë është 2.541m², ndërsa për personel akademik është 515 m². Në takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas kuadrit rregullator në fuqi.</p> <p>Falë rikonstruksionit të përgjithshëm që pritet të përfundojë brenda këtij viti akademik, të gjitha sallat e leksioneve do të jenë të pajisura me teknologjinë e nevojshme për të garantuar realizimin sa më cilësor të proçesit mësimor dhe për të mundësuar përdorimin e metodave bashkëkohore në këtë proçes.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.15 raporti i kontrollit të kapaciteteve.pdf; shtojca 3.37 rikonstruksioni i godines së fe.pdf; shtojca 4.5 tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit.pdf; vizita në institucion]</i></p>	Mjedisi	Nr. Sallash	Salla leksioni	7	Salla seminari	15	Laborator informatike/lëndësh	4	Zyra për stafin akademik	10	Bibliotekë / Internet	2	Ambiente ndihmëse (fotokopje/zyra info/ të tjera ndihmëse)	5
Mjedisi		Nr. Sallash													
Salla leksioni	7														
Salla seminari	15														
Laborator informatike/lëndësh	4														
Zyra për stafin akademik	10														
Bibliotekë / Internet	2														
Ambiente ndihmëse (fotokopje/zyra info/ të tjera ndihmëse)	5														
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për proçesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të proçesit mësimor dhe praktikave.</p>															
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike,</p>	<p>Sipas RVB dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik disponon zyra të pajisura me kompjuter dhe</p>														

<p>infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>me mbulim interneti. Zhvillimi i procesit mësimor on-line gjatë një viti e gjysëm akademik, ka bërë të mundur ofrimin dhe konsolidimin e infrastrukturës së IT të menaxhuar nga institucioni. Mësimi online është ofruar nëpërmjet aplikacioneve Moodle, eduMEET, Google Meet, Google Classroom, Microsoft Teams, etj. Gjithashtu institucioni ka nënshkruar edhe një marrëveshje me Rrjetin Akademik Shqiptar për aplikimin dhe mirëmbajtjen e sistemit Esse3. [Referenca: shtojca 3.16 model mësimi online.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në programet e lëndëve GVJ konstatoi se titujt e përfshirë në literaturën bazë dhe ndihmëse të këtij programi përmbushin objektivat e studimit të tij dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program. Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe dhe të miratuar në njësinë bazë. Institucioni ka miratuar edhe një udhëzim mbi procedurat e miratimit, botimit dhe shpërndarjes së teksteve mësimore në njësinë bazë. [Referenca: shtojca 1.12 udhëzues për procedurat e miratimit, botimit dhe shpërndarjes së teksteve.pdf; shtojca 3.31 informacion mbi bibliotekën online.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore PS.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë disponon një bibliotekë të pajisur me literaturë fizike: 5316 libra në gjuhë të huaja dhe gjuhë shqipe. Nga vizita në këtë bibliotekë (aktualisht e transferuar për shkak të rikonstruksionit të godinës së FE) dhe informacioni i marrë më pas, rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të FE si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaja; libra, revista dhe botime të institucioneve të tjera. Studentët, personeli akademik dhe personeli administrative, si dhe komuniteti kanë akses në përdorimin e literaturës që gjendet në bibliotekë nga dita e hënë deri në ditën e premtë, nga ora 8.00-16.00. [Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 3.41 lista e plotë e librave të dhuruara.pdf; shtojca 4.6 & 4.7 raport për fondin e librave dhe infrastrukturën e bibliotekave.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>UK është pjesë e projektit të MASR për ofrimin e shërbimeve të bibliotekës on-line për universitetet publike "ULIBRARY". Përmes adresës http://ulibrary.rash.al/, studentët mund të kërkojnë për artikuj, studime, apo botime të tjera sipas fushës së interesit bazuar në identifikimin e përzgjedhur në universitetin ku janë regjistruar. Gjithashtu falë bashkëpunimit me Fondacionin American Development Foundation (ADF), UK ka</p>

	<p>mundësuar shfrytëzimin falas edhe të platformës së bibliotekës online J-Store përmes aksesit të dedikuar, brenda dhe jashtë ambienteve të institucionit, për të gjithë studentët dhe stafin akademik.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 3.19 biblioteka elektronike e institutit të mikpritjes.pdf; shtojca 3.31 informacion biblioteka online u-library.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Për shkak të rikonstruksionit në proces të ambienteve të FE, GVJ mund të bënte vetëm një vrojtim nga jashtë të tyre. Megjithatë bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve janë tashmë dy laboratorë të teknologjisë së informacionit të cilëve pritet t'u shtohet dhe një laborator i tretë si kontribut i projektit të fituar prej Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Nëpërmjet aplikacioneve Moodle, eduMEET, Google Meet, Google Classroom, Microsoft Teams dhe platformës Esse3 personeli akademik ka mundësi të komunikojë me studentët duke iu ofruar informacione të ndryshme mbi lëndën, leksione dhe materiale të tjera shtesë, duke realizuar teste dhe pyetësorë të ndryshëm etj.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.18 manual mësimi online.pdf; shtojca 3.16 model mësimi online.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se personeli akademik dhe ndihmës, si dhe studentët përdorin platformën Esse3 nëpërmjet një llogarie personale dhe fjalëkalimi. Studentët e programit dhe stafi akademik kanë mundësinë që nëpërmjet kredencialeve personale të aksesojnë dokumentacionin elektronik. Për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me Ligjin nr. 9887, Universiteti “Fan S. Noli” ka miratuar një rregullore të posaçme.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.9 rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit përcakton fushat e studimit ku mund të drejtohet punimi i temës së diplomës. Nga vizita në institucion GVJ iu konfirmua se Departamenti i Financë-Kontabilitetit informon studentët, për fushat e studimit dhe tematikat orientuese për tezat e diplomës. Tema e diplomës zgjidhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin e temës i cili i asiston dhe orienton gjatë gjithë kohës së përgatitjes së</p>


	punimit të diplomës. Me paraqitjen e punimit, pedagogu udhëheqës bën edhe verësimin e punës së studentit, nëpërmjet një formulari standard. <i>[Referenca: shtojca 2.5 rregullore e PS.pdf; shtojca 2.31 udhëzues i diplomës MP.pdf, shtojca 3.34 format vlerësimi i punimit të diplomës.pdf]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, Statutin dhe rregulloren e UK, GVJ vlerëson se në funksion të procesit mësimor-kërkimor, në nivel universiteti janë organizuar struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni, (SKVIA) pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor; ▪ Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor pranë çdo njësie bazë; ▪ Zëvendës Rektori për mësimin; <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), strukturë brenda SKVIA, koordinon aktivitetet dhe bashkëpunon me personelin akademik të fakultetit dhe departamentit përgjegjës për programin e studimit, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë të institucionit. GVJ konstatoi se sipas Manualit të Sigurimit të Cilësisë, NJSBC përbëhet nga 6 anëtarë: katër përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore, një përfaqësues i studentëve dhe një përfaqësues i sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë ndërsa sipas parashikimeve në Statutin e UK (<i>neni 74</i>), NJSBC përbëhet nga 7 anëtarë, ku përfshihet edhe një ekspert i jashtëm.</p> <p><i>GVJ gjykon se duhet të unifikohen aktet rregullatore të miratuara nga institucioni lidhur me NJSBC.</i></p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 1.5 rregullore e drejtorisë së kurrikulave.pdf; ; shtojca 1.16 manuali i sigurimit të cilësisë.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe</p>	<p>Bazuar në rregulloren e njësisë kryesore, rezulton se veprimtaria e ndjekjes dhe garantimit të cilësisë së mësimdhënies rregullohet dhe mbikqyret në nivel fakulteti.</p>

<p>studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sipas kësaj rregulloreje, përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në nivel njësie bazë është Departamenti i Financë-Kontabilitetit, detyrat e të cilit janë të parashikuara në rregulloren e tij. Gjithashtu pranë FE, është ngritur NJSBC sipas kërkesës së Manualit të Cilësisë. GVJ konstaton se Njësia kryesore dhe ajo bazë duke u mbështetur në legjislacionin rregullator të institucionit janë të afta të ushtrjnë funksionet e tyre nëpërmjet hartimit të planit të masave dhe kontrollin e vazhdueshëm të tyre me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies, sipas kërkesave bashkëkohore.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.16 manuali i sigurimit të cilësisë.pdf; shtojca 3.4 lista e njsbc.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë i mbështetur nga strukturat përgjegjëse të Universitetit “Fan S. Noli”, ka organizuar trainime për aplikimin e metodave të reja mësimdhënies si Moodle, eduMEET, Google Meet, Google Classroom, Microsoft Teams, etj, të cilat kanë mundësuar një mësim cilësor sidomos gjatë periudhës së zhvillimit online të aktivitetit mësimor.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.18 manual mësimi online.pdf; shtojca 3.16 model mësimi online.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion konstatohet se personeli akademik është angazhuar vazhdimisht në aktivitete shkencore si konferenca dhe simpoziume, si dhe ka botuar artikuj në revista shkencore vendase dhe të huaja për rritjen e kualifikimit të tij shkencor dhe fitimin e titujve dhe gradave shkencore.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Gjithashtu institucioni ka kryer trajnime për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies të personelit akademik nëpërmjet zbatimit të metodave inovative të mësimdhënies. Në mënyrë më specifike janë kryer trajnime lidhur me përdorimin e sistemit të manaxhimit të informacionit Esse3, mbi platformat e mësimdhënies si Moodle, eduMEET, Google Meet, Google Classroom, Microsoft Teams, mbi përdorimin e bibliotekës online U-Library.</p> <p><i>Megjithatë GVJ rekomandon nxitjen e pjesëmarrjes së personelit akademik në trajnime të dedikuara në funksion të rritjes së kompetencave të tyre shkencore dhe mësimdhënëse përmes rritjes së projekteve të bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë dhe mbështetjes financiare përkatëse.</i></p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.18 manual mësimi online.pdf; shtojca 2.9 jetëshkrimet e stafit të përfshirë në PS.pdf; shtojca 3.16 model mësimi online.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë</p>	

<p>përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Rregulloret e institucionit, njësisë kryesore dhe bazë specifikojnë qartë detyrat e personelit akademik dhe ndihmësakademik për zbatimin e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi se personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik shfrytëzojnë maksimalisht mundësitë e ofruara nga institucioni për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja të mësimdhënies. Gjithashtu GVJ konstatoi se personeli akademik raporton në mënyrë periodike mbi veprimtarinë mësimore. Ky raport vetvlerësimi monitorohet nga përgjegjësi i departamentit dhe bëhet pjesë e analizës vjetore të departamentit, ku mes të tjerash diskutohen efektet dhe problematikat e ndeshura gjatë përdorimit të metodave innovative të mësimdhënies.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf; shtojca 3.17 model analiza në përfundim të një moduli.pdf]</i></p>											
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ nuk konstatoi përfshirje të lektorëve apo kërkuesve shkencorë të jashtëm (vendas ose të huaj) gjatë zhvillimit të këtij programi studimi.</p>											
<p>Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> <table border="1" data-bbox="638 1232 1458 1368"> <thead> <tr> <th data-bbox="638 1232 798 1310">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="798 1232 1013 1310">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1013 1232 1228 1310">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1228 1232 1458 1310">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="638 1310 798 1368"></td> <td data-bbox="798 1310 1013 1368"></td> <td data-bbox="1013 1310 1228 1368" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1228 1310 1458 1368"></td> </tr> </tbody> </table>				Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht									
		X										

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregulloren e njësisë kryesore, (neni 74) “Format e vlerësimit” dhe (neni 75) “Format e kontrollit të dijeve”.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se këto dokumentacione janë publike për personelin akademik kurse studentëve u njoftohen kriteret dhe mënyra e testimit të</p>



37

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>njohurive nga pedagogët në auditor kur bëhet prezantimi i syllabuseve për lëndët përkatëse.</p> <p>Gjithashtu studentët kanë mundësi të informohen mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të dijeve dhe njohurive edhe nëpërmjet llogarisë së tyre personale në sistemin Esse3.</p> <p>[Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf]</p>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Rregullorja e njësisë kryesore, (neni 75), parashikon si forma të kontrollit dhe vlerësimit të nivelit të njohurive që studenti ka përvetësuar gjatë aktivitetit mësimor testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, punët në grup, projektet, prezantimet, praktikat dhe temën e diplomës.</p> <p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore, GVJ krijoi bindjen se vlerësimi i studentëve realizohej në bazë të formave të parashikuara në rregullore duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> <p>[Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe programet e lëndëve, si dhe informacionet e marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive në programin e studimit “Master Profesional në Financë dhe Kontabilitet” realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe merret në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të studentit.</p> <p>Konkretisht sipas rregullores së programit të studimit në vlerësimin e vazhdueshëm përfshihen pikët e frekuentimit dhe aktivizimit në veprimtari mësimore, rezultatet e arritura në seminare, kolokiume, detyra e tema kursi dhe forma të tjera të kontrollit të ushtruara gjatë semestrit.</p> <p>[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf; shtojca 2.8 programet lëndore të PS.pdf]</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Universiteti “Fan S. Noli” ka vënë në dispozicion të programeve të studimit të ofruara, aplikacione të ndryshme elektronike si Moodle, eduMEET, Google Meet, Google Classroom, Microsoft Teams etj., të cilat përveç procesit të mësimdhënies përdoren edhe për testimin e njohurive dhe vlerësimin e studentëve. Gjithashtu institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me fondacionin AADF e cila parashikon edhe</p>

	<p>përfshirjen e sistemit të integruar teknologjik në vlerësimin e performances së studentëve në provime.</p> <p>[Referenca: shtojca 2.18 manual mësimi online.pdf; shtojca 3.16 model mësimi online.pdf; shtojca 3.39 raporti i implementimit të projektit clean score.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Ngritja e komisioneve të provimit rregullohet nga (neni. 79) i rregullores së njësisë kryesore, sipas së cilës komisioni i provimit përcaktohet nga përgjegjësi i departamentit, pra komisioni përbëhet nga të paktën dy anëtarë. Në rast mungese të njërit prej pedagogëve dhe pamundësisë, provimi shtyhet pesë ditë jashtë sezonit, me propozim të dekanit dhe miratim të rektorit.</p> <p>[Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se provimet me shkrim zhvillohen me procedurë sekretimi, duke mbajtur të anonim emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu vendos vlerësimin përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjithashtu në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ mori konfirmimin se në FE, bëhet një korrigjim i kujdesshëm i provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, si edhe i detyrave të kursit të studentëve, duke dhënë edhe këshilla në funksion të përmirësimit të punës së studentëve në të ardhmen.</p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; vizita ne institucion]</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik ndjekin përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën. Gjatë kohës së provimit, salla monitorohet nga dy ose më shumë pedagogë, kopjimi nuk tolerohet dhe sipas rregullores së FE (neni 80) ndalohet përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të palejueshme.</p> <p>Në Kodin e Etikës të Uk janë parashikuar dispozita që dënojnë sjellje që lidhen me plagjiaturën, kopjimin dhe mashtrimin gjatë procesit mësimor, të cilat janë përfshirë edhe në syllabuset e lëndëve.</p> <p>[Referenca: shtojca 1.20 kodi i etikës së uniko.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; vizita ne institucion]</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rregullorja e njësisë kryesore (neni 82) kërkon nga pedagogët që rezultatet e provimit tu komunikohen studentëve brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të tij, që u konfirmua edhe nga stafi akademik gjatë vizitës në institucion. Studentët informohen për rezultatet e provimit nëpërmjet librezës elektronike ose pranë sekretarisë së departamentit. GVJ gjykon që institucioni përdor</p>

	instrumenta efektive për të garantuar rezultate të bazuara mbi meritat e punës së studentit. [Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf]			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ konstaton se Rregullorja e UK, Rregullorja e FE dhe Rregullorja e Departamentit, në nenet përkatëse, parashikojnë të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, kundrejt një kërkesë me shkrim që i drejtohet Dekanit të FE brenda 8 ditëve nga dita e provimit me shkrim. Kërkesat dorëzohen pranë personelit ndihmës akademik në departament. Pas sqarimeve të nevojshme me përgjegjësen e departamentit, komisionin e provimit dhe studentin, Dekani brenda dy ditëve vijon me komunikimin e vendimit përkatës. Në rast se ankesa është e drejtë, studentit i jepet e drejta të rijapë provimin me një komision të ri në një datë tjetër por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Një kopje të pasqyrës së detyrimeve dhe provimit e mban Sekretaria mësimore e njësisë kryesore dhe një kopje e mban sekretaria e departamentit. Procedura e ndjekur gjatë procesit të ankimimit së bashku me vendimin depozitohet në Dekanat. [Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf]			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Master Profesional në Financë - Kontabilitet me përmbajtjen e tij u jep njohuri specifike studentëve në fushën e shërbimeve financiare, të auditimit, tregut të sigurimeve, të kontabilitetit etj. <i>Nga studimi i planit mësimor GVJ është i mendimit se:</i> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>programi i studimit duhet të plotësohet me një lëndë bankare, meqënëse edhe sipas studimit të tregut sektori bankar përbën një potencial të madh për punësimin e studentëve;</i> ▪ <i>të hiqet nga programi një nga lëndët "Financa ndërkombëtare" ose "Drejtimit financiar ndërkombëtar" pasi janë dy lëndë në një fushë, e cila edhe sipas studimit të tregut dhe sipas qëllimit të programit të studimit nuk ka</i>

	<p><i>shumë lidhje me specialitetet që synon të formojë ky program studimi;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>duhet të zgjatet 4-6 javë praktika profesionale.</i> <p><i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor.pdf; shtojca 2.8 programi lëndor.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Plani mësimor i programit “Master Profesional në Financë – Kontabilitet, përmban një lëndë “Kontabiliteti Aplikativ” e cila u mundëson studentëve përdorimin e software-ve të kontabilitetit për organizimin dhe mbajtjen e një sistemi të informacionit kontabël. Lënda parashikohet të zhvillohet në laboratorë të pajisur me pajisjet dhe programet përkatëse kompjuterike.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor.pdf; shtojca 2.8 programi lëndor.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se sipas programeve të studimit, kompetencat dhe aftësitë e studentit vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë zhvillimit të programit mësimor nëpërmjet diskutimeve, detyrave/projekteve të kursit, si edhe në përfundim të lëndës me provimin përfundimtar, i cili sipas rregullores së programit të studimit, në varësi të specifikave të lëndës mund të zhvillohet me gojë ose me shkrim.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor.pdf; shtojca 2.8 programi lëndor.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se në përfundim të çdo lënde, pedagogu përkatës informon studentët mbi pikët e fituara gjatë vlerësimit të vazhdueshëm dhe u jep informacion studentëve mbi strukturën e provimit dhe çështjet më të rëndësishme ku duhet të fokusohen.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e FE.pdf; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe të marrë në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi organizimin e prezantimeve të hapura në nivel fakulteti, të lidhura kryesisht me angazhimin në projektet e reja.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 3.38 projekti fitues; vizita ne institucion]</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe programeve lëndore GVJ konstatoi se programi i studimit “Master në Financë – Kontabilitet, përmban një lëndë që zhvillohet në laborator nëpërmjet të cilës kanë mundësi të zhvillojnë aftësitë teknologjike në fushën e kontabilitetit. Ndërsa praktika profesionale është një detyrim akademik që zhvillohet në fund të semestrit të dytë, në pozicione pune sa më pranë fushës së studimit të programit dhe u jep mundësinë studentëve të vënë në zbatim njohuritë teorike të marra në auditor.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor.pdf; shtojca 2.8 programi lëndor.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në</p>	

grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Në takimet me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ata mbështesin diskutimet dhe idetë e studentëve në zgjidhjen e problematikave të caktuara. Programet lëndore inkurajojnë punën në grup nëpërmjet detyrave të kursit, analizës së rasteve të studimit duke i parë si një zhvillim të aftësive të studentit për të komunikuar dhe bashkëpunuar në të ardhmen me kolegët në vendin e punës.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Personeli akademik motivon dhe nxit idetë inovative dhe punën kërkimore dhe shkencore të studentëve nëpërmjet diskutimeve, projekteve të kursit dhe praktikës profesionale, gjithmonë brenda kuadrit të këtij program studimi. Sipas RVB institucioni mbështet financiarisht pjesëmarrjen e studentëve në projekte dhe vë në shërbim të tyre ambientet e institucionit. Megjithatë GVJ nuk konstatoi ndonjë pjesëmarrje konkrete të studentëve në projekte apo të dhëna mbi ndonjë financim nga institucioni të nismave nga studentët. <i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf; shtojca 3.38 projekti fitues; vizita ne institucion]</i>			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në UK, konstatohet se Drejtoria e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit me institucionet përmes përfshirjes në projekte të ndryshme. Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, përfshirë edhe projektet ndërkombëtare janë realizuar një numër mobilitetesh në nivel FE të cilat përfshijnë edhe mobilitetin e studentëve. Bazuar në dokumentacionin shoqërues dhe informacionin e marrë në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ nuk konstatoi ndonjë mobilitet të studentëve të këtij programi studimi. <i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; vizita ne institucion]</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Në bazë të dokumentacionit dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ofron mjedise të përshtatshme laboratorike për të zhvilluar lëndën “Kontabilitet Aplikativ” si dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione private dhe publike, të cilat ofrojnë mjediset e tyre për zhvillimin e praktikës profesionale.

	<i>[Referenca: shtojca 2.10 marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave.pdf; shtojca 4.5 tabela e të dhënave infrastrukturor.pdf]</i>			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Sipas planit mësimor, institucioni nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit garanton kryerjen e praktikave profesionale, por nuk parashikon kryerjen e stazheve tek institucionet partnere. <i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor.pdf; shtojca 2.10 marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave.pdf]</i>			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale zhvillohet dy javët e fundit të semestrit të dytë dhe vlerësohet në planin mësimor me dy kredite. Udhëzuesi i praktikës profesionale përcakton qartë detyrimet e studentit, institucionit ku zhvillohet praktika dhe departamentit të Financë Kontabilitetit. Në përfundim të praktikës, studenti duhet të hartojë një raport analitik mbi punën e kryer dhe njohuritë e përfituara gjatë zhvillimit të praktikës profesionale, mbikqyrësi në institucionin ku zhvillohet praktika duhet të plotësojë një formular duke dhënë vlerësimin mbi punën e studentit, dhe udhëheqësi duhet të vlerësojë realizimin ose jo të praktikës nga ana e studentit. Te tre këto dokumente së bashku me prezantimin që bën studenti, merren në konsideratë nga komisioni i mbrojtjes së praktikës dhe bëhet vlerësimi me notë i studentit. <i>[Referenca: shtojca 2.13 programi i praktikës profesionale.pdf]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Procedura e diplomimit të programit të studimit rregullohet nëpërmjet rregullores së njësisë kryesore, rregullores së programit të studimit si dhe udhëzuesit të diplomës. Udhëzuesi i diplomës u bëhet i njohur studentëve që në fillim të përgatitjes së punimit të diplomës. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se diplomimi realizohet nëpërmjet mbrojtjes së një punimi diplome, ndërsa sipas Rregullores së programit të studimit diplomimi bëhet me provim formimi ose me mbrojtjen e temës së diplomës. <i>GVJ sugjeron korrigjimin dhe rishikimin e rregullores së programit të studimit lidhur me mënyrën e mbrojtjes së diplomës.</i>

	<i>[Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf; shtojca 2.31 udhëzues i diplomës së MP.pdf]</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ mori konfirmimin se personeli akademik, koordinatori i programit të studimit, QKA dhe sekretaria mësimore informojnë studentët mbi të gjithë procesin e diplomimit që nga përzgjedhja e temës dhe deri në mbrojtjen përpara komisionit, duke u vënë në dispozicion edhe udhëzuesin e diplomimit.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Sipas rregullores së programit të studimit, departamenti përcakton listën e temave për diploma. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga përgjegjësja e departamentit dhe përzgjedhja e temës bëhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin. <i>[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf; shtojca 2.31 udhëzues i diplomës së MP.pdf; shtojca 2.30 pedagogët udhëheqës të temave të diplomës.pdf; vizita ne institucion]</i>
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik mbështet studentët përgjatë gjithë procesit të diplomimit. Biblioteka, laboratorët dhe ambiente të tjera të fakultetit mund të shfrytëzohen nga studentët për kryerjen e hulumtimeve, analizave dhe përgatitjes së temës dhe prezantimit të diplomës.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Pedagogu udhëheqës i udhëzon studentët për strukturën e punimit të diplomës, metodologjinë, i orienton studentët drejt literaturës që ata duhet të lexojnë në funksion të projektit, u jep udhëzime dhe të gjitha materialet e nevojshme për përfundimin me sukses të projektit. Pasi miraton punimin, udhëheqësi bën edhe vlerësimin me pikë të punës së studentit. <i>[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf; shtojca 2.31 udhëzues i diplomës së MP.pdf; shtojca 3.34 format vlerësimi i punimit të diplomës.pdf; vizita ne institucion]</i>
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Mbrojtja e temës së diplomës bëhet me anë të prezantimit të materialit në power-point, para komisionit i cili përbëhet nga tre pedagogë. Për vlerësimin e temës mbahen parasysh kriteret e përcaktuara në udhëzimin e diplomës. Vlerësimi bëhet me notë mbështetur në vlerësimin e drejtuesit të diplomës dhe të komisionit. <i>[Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e PS.pdf]</i>
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studenti pajiset me diplomë "Master Profesional" në programin e studimit të kryer, të firmosur nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë dhe Rektori i UK, e cila është një dokument zyrtar. Diploma shoqërohet me listën e notave dhe me suplementin e

	diplomës sipas modelit të miratuar. Emërtimi i diplomës bëhet në përputhje me programin e studimit të ndjekur nga studenti. [Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.6 model suplementi i diplomës së PS.pdf]			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sipas RVB, me kërkesën e studentit, i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e programit të studimit të nënshkruar nga Dekani dhe drejtuesi i njësisë bazë.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë përcakton që njësia kryesore ruan të dhënat personale të studentëve, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Sipas RVB, dokumentacioni i regjistrimit të studentit ruhet në sekretarinë mësimore edhe pas diplomimit dhe i vihet të dispozicion studentit me kërkesën e tij. [Referenca: shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të dosjes së vetëvlerësimit (RVB) dhe informacionin e marrë në takimet e realizuara gjatë vizitës në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë (UK), GVJ konstatoi se institucioni mban të dhëna të plota mbi personelin e angazhuar në këtë program studimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UK. Në takimin me përfaqësuesin e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore (DJBNJ) të UK, GVJ u informua mbi përmbajtjen e dosjes së personelit dhe procedurën e përditësimit të saj sipas rregullores përkatëse të DJBNJ. Referuar Tabelave 6.1,6.2 & 6.3 në Shtojcën 4.1, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike paraqiten si vijon:

<p>mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar 11 pedagogë, të gjithë PAE, ndër të cilët 5 me titullin Prof. As. Dr. dhe 6 me gradën Dr. Mbulimi i programit në përqindje për këtë vit akademik është 100% nga PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 11 pedagogë, të gjithë PAE, ndër të cilët 5 me titullin Prof. As. Dr. dhe 6 me gradën Dr. Mbulimi i programit në përqindje për këtë vit akademik është 100% nga PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 janë të angazhuar 11 pedagogë, të gjithë PAE, ndër të cilët 5 me titullin Prof. As. Dr., 5 me gradën Dr dhe 1 MSc. Mbulimi i programit në përqindje për këtë vit akademik është 100% nga PAE.</p> <p>GVJ konstatoi se pranë departamentit përgjegjës për programin e studimit, departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ka vetëm një personel ndihmës-administrativ.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar.pdf; shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 1.4 rregullorja e drejtorisë së burimeve njerëzore.pdf; shtojca 1.14 udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit.pdf; shtojca 4.1 tabela përmbledhëse për programin e studimit.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të dosjes së vetëvlerësimit (RVB) dhe i formacionin e marrë në takimet e e realizuara gjatë vizitës në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë (UK), GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UK. Në Statutin e UK (neni 45) përcaktohet se konkurimi i personelit mbikqyret nga një komision i posaçëm me pesë anëtarë: një nga Rektorati, një nga Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore (DJBNJ), një nga Dekanati i njësisë kryesore dhe dy anëtarë nga njësia bazë.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në takimin me përfaqësuesin e DJBNJ të UK, GVJ u informua se kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit për çdo vend pune, në përputhje me specifikat e programit të studimit, publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare web të UK.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë për zgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret e punësimit të personelit akademik përcaktohen nga njësia bazë, nga Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë dhe miratohen nga Rektori i UK. Procesi i rekrutimit ndiqet nga Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me njësinë bazë përkatëse.</p> <p>Në “Rregulloren e Njësisë Bazë” (nenet 11-13), në “Rregulloren e Njësisë Kryesore” (nenet 16-18 & 23-24) dhe në “Rregulloren e Organizimit të UK” (nenet 32 & 41) përcaktohen qartë</p>

	<p>procedura dhe kriteret që ndiqen në rekrutimin e personelit sipas kategorive.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit “Master Profesional në Financë-Kontabilitet”.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Në takimin me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi angazhimin dhe mbështetjen e UK për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik përmes trajnimeve, kualifikimeve të mëtejshme profesionale, përfshirjes në projekte bashkëpunimi dhe shkëmbimi me institucione partnere kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe nxitjes së publikimit të punës kërkimore. Fokusi kryesor i trainimeve ka qenë përdorimi i platformave online në mësimdhënie si Office 365 dhe Google Teams, si dhe i platformës U-CRIS si databazë për publikimet shkencore.
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Vëmendja e UK për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit shprehet qartë edhe në objektivat kryesorë të zhvillimit strategjik të vendosura në planin strategjik të zhvillimit të institucionit për periudhën 2022-2027. <i>[Referenca: shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 1.3.1 draft plani strategjik i zhvillimit.pdf; shtojca 2.14 plani i veprimit për “instalimi i platformes office 365 for education”.pdf; shtojca 3.32 trajnim i stafit për platformën ucris.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se aktualisht stafi akademik me kohë të plotë i departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, mbulon mesatarisht

<p>programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>3-5 lëndë (në të gjitha programet dhe nivelet e studimit) me një ngarkesë mesatare orësh në auditor prej 366 orë për pedagog (Tabela 4 në shtojcën 4.1).</p> <p>GVJ gjykon se pavarësisht se kjo është tashmë një praktikë e përhapur dhe e pranuar në universitetet publike shqiptare (brenda kufirit maksimal të lejuar nga VKM përkatëse por 2-3 herë më shumë se ngarkesa bazë e miratuar sipas kategorive/pozicioneve), një ngarkesë e tillë mund të çënojë realizimin cilësor të objektivave të programit të studimit dhe mund të kufizojë personelin akademik të angazhuar sidomos përsa i takon kërkimit shkencor dhe mobiliteteve.</p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 4.1 tabela përmbledhëse për programin e studimit.pdf; shtojca 4.2 tabela e ngarkesës të personelit akademik.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.3</p>					
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.</p>					
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>				
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet me drejtuesit dhe stafin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi se programi i studimit “Master Profesional në Financë-Kontabilitet” i zhvillon aktivitetet mësimore në godinën e Fakultetit të Ekonomisë të UK. Aktualisht kjo godinë është në proces rikonstruksioni të përgjithshëm të infrastrukturës për t’u garantuar studentëve dhe pedagogëve kushte sa më të përshtatshme për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore.</p>				
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se me përjashtim të vitit të shkuar, ku si pasojë e pandemisë Covid-19 mësimi u zhvillua online në periudhat e tjera mësimi është zhvilluar në ambientet e parashikuara të FE, gjatë ditëve të javës dhe në orare të përshtatshme për studentët.</p> <p>Të dhënat në vijim i referohen përmbledhtas mjediseve kryesore në dispozicion të studentëve dhe personelit pranë FE të UK:</p> <table border="1" data-bbox="699 1928 1353 2007"> <thead> <tr> <th>Mjedisi</th> <th>Nr. Sallash</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla leksioni</td> <td>7</td> </tr> </tbody> </table>	Mjedisi	Nr. Sallash	Salla leksioni	7
Mjedisi	Nr. Sallash				
Salla leksioni	7				

	<table border="1"> <tr> <td>Salla seminari</td> <td>15</td> </tr> <tr> <td>Laborator informatike/lëndësh</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Zyra për stafin akademik</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>Bibliotekë / Internet</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Ambiente ndihmëse (fotokopje/zyra info/ të tjera ndihmëse)</td> <td>5</td> </tr> </table>	Salla seminari	15	Laborator informatike/lëndësh	4	Zyra për stafin akademik	10	Bibliotekë / Internet	2	Ambiente ndihmëse (fotokopje/zyra info/ të tjera ndihmëse)	5
Salla seminari	15										
Laborator informatike/lëndësh	4										
Zyra për stafin akademik	10										
Bibliotekë / Internet	2										
Ambiente ndihmëse (fotokopje/zyra info/ të tjera ndihmëse)	5										
	<p>Falë rikonstruksionit të përgjithshëm që pritet të përfundojë brenda këtij viti akademik, të gjitha sallat e leksioneve do të jenë të pajisura me teknologjinë e nevojshme për të garantuar realizimin sa më cilësor të procesit mësimor dhe për të mundësuar përdorimin e metodave bashkëkohore në këtë proces.</p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.15 raporti i kontrollit të kapaciteteve.pdf; shtojca 3.37 rikonstruksioni i godines së fe.pdf; shtojca 4.5 tabela e të dhënave infrastrukture në funksion të programit.pdf; vizita në institucion]</p>										
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për shkak të rikonstruksionit në proces të ambienteve të FE, GVJ mund të bënte vetëm një vrojtim nga jashtë të tyre. Megjithatë bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve janë tashmë dy laboratorë të teknologjisë së informacionit të cilëve pritet t'u shtohet dhe një laborator i tretë si kontribut i projektit të fituar prej Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.</p>										
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Financë-Kontabilitet” nuk ka kërkesa për laboratorë specifikë dhe aktualisht praktika profesionale dy javore realizohet në mjediset jashtë UK, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit që Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ka lidhur për këtë qëllim me institucione shtetërore, shoqëri tregtare, studio profesionale dhe sipërmarrje të tjera private.</p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 2.10 marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.pdf; vizita në institucion]</p>										
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>											
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X		
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht								
			X								
<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</p>											
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>										
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve</p>											

<p>bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitë në institucion, GVJ konstatoi se UK vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar pranë këtij universiteti Bibliotekën Shkencore, të organizuar në disa ambiente, kundrejt një anëtarësimi me kartelë identifikimi dhe pa pagesë.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët e Fakultetit të Ekonomisë frekuentojnë kryesisht sallën e Bibliotekës, që ndodhet në godinën ku zhvillohet edhe procesi mësimor i këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në këtë bibliotekë (aktualisht e transferuar për shkak të rikonstruksionit të godinës së FE) dhe informacioni i marrë më pas, rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të FE si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, revista dhe botime të institucioneve të tjera. Biblioteka mund të shfrytëzohet njëjloj nga të gjithë studentët, stafi i universitetit si dhe komuniteti.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 3.41 lista e plotë e librave të dhuruara.pdf; shtojca 4.6 & 4.7 raport për fondin e librave dhe infrastrukturën e bibliotekave.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>UK është pjesë e projektit të MASR për ofrimin e shërbimeve të bibliotekës on-line për universitetet publike “ULIBRARY”. Përmes adresës http://ulibrary.rash.al/, studentët mund të kërkojnë për artikuj, studime, apo botime të tjera sipas fushës së interesit bazuar në identifikimin e përzgjedhur në universitetin ku janë regjistruar. Gjithashtu falë bashkëpunimit me Fondacionin American Development Foundation (ADF), UK ka mundësuar shfrytëzimin falas edhe të platformës së bibliotekës online J-Store përmes aksesit të dedikuar, brenda dhe jashtë ambienteve të institucionit, për të gjithë studentët dhe stafin akademik. GVJ konstatoi se edhe më herët, FE ka përfutur falas libra dhe akses në bibliotekat online nga marrëveshje bashkëpunimi të ngjashme.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet me stafin akademik të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, GVJ konkludon se institucioni harton planin për shtimin e zërave/titujve në fondin e bibliotekës sipas mundësisë (disponibilitetit buxhetor) duke ju referuar kërkesave që njësitë bazë, zakonisht një herë në vit, hartojnë bazuar në preferencat e stafit akademik lidhur me titujt e botimeve për të cilat kanë interes. GVJ konstaton se oraret e shërbimit të bibliotekës (nga e hëna-të premtë dhe orari 8.00-</p>

	16.00) janë në përputhje me nevojat e studentëve të këtij program studimi por edhe të interesuarve të tjerë. [Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 3.19 biblioteka elektronike e institutit të mikpritjes.pdf; shtojca 3.28 praktika pasurimi të fondit të bibliotekave.pdf; shtojca 3.31 informacion biblioteka online u-library.pdf; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara me stafin dhe studentët e këtij program studimi, gjatë vizitës në UK, GVJ u informua se institucioni përdor sistemin Esse3 për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët dhe për përfitimin e shërbimeve online nga ana e studentëve. Përdorimi i platformës Esse3, rezultat i pjesëmarrjes së UK në projektin e RASH për rrjetin telematik për universitetet, si dhe rregullorja përkatëse janë miratuar nga Senati i UK në korrik të vitit 2019. Kjo platformë përmes aplikacioneve të integruara, në mbështetje të proceseve të administrimit, mësimdhënies, komunikimit dhe vetëshërbimit për studentët, u mundëson informacion të plotë dhe të dedikuar të gjitha palëve të angazhuara në realizimin e këtij programi studimi si: regjistrimi i studentëve, informacion mbi programin e studimit, orarin mësimor, kalendarin e provimeve, regjistrat dhe procesverbalet e provimeve, komunikime të ndryshme mësimore & administrative (tarifa regjistrimi, fatura përkatëse) etj. Esse3 parashikon mundësinë e përfshirjes në të ardhmen të moduleve shtesë si menaxhimi financiar dhe burimet njerëzore të institucionit. <i>Gjatë vizitës në institucion (dhe deri në fund të kohës së përgatitjes së këtij raporti) GVJ konstatoi mos funksionimin e faqes zyrtare web të UK dhe të ndërlidhjes së sistemit Esse3 për arsye administrative që pritej të zgjidhej në ditët në vijim.</i> Sekretaria mësimore e FE të UK është struktura që administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi. Gjatë
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	

	<p>vizitës në sekretari GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen e plotë të dy studentëve të programit të studimit “Master Profesional në Financë-Kontabilitet” dhe përdorimin e regjistrave përkatës sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>Në takimin me përfaqësuesin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se kjo strukturë ndër të tjera, merrej dhe me administrimin e informacionit të përgjithshëm mbi personelin e angazhuar në këtë program studimi në formën e dosjes personale të personelit, kontratës dhe librezës së punës, regjistrin themeltar etj. Ndërsa administrimi i informacionit lidhur me aktivitetin mësimor dhe shkencor të personelit akademik realizohej në nivel njësie bazë. Ky proces përfshin përditësimin e CV, programeve të lëndëve, leksionet e parashkuara, formatet e ngarkesës, formatet e ndryshme të vlerësimit etj, si për stafin akademik me kohë të plotë edhe për stafin me kontratë.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.10 rregullore e sekretarisë mësimore.pdf; shtojca 1.14 udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit.pdf; shtojca 1.6 rregullore esse3.pdf; shtojca 3.25 marrëveshje institucionale.pdf; https://www.unkorce.esse3.u-gov.rash.al/; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se sistemi Esse3 mundëson përdorimin e dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në takimet e zhvilluara me stafin dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se aktualisht shkëmbimet e informacionit ndërmjet përdoruesve të Esse3 përqendroheshin kryesisht në përdorimin e platformës për konsultimin e informacioneve apo dokumenteve si orari mësimor, programi mësimor, lëndët, listat e notave, krediteve, fatura për regjistrim dhe për shërbime të tjera etj. Përdorimi i platformës për aktivitete të tjera administrimi ishte i kufizuar ose mungonte fare.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>GVJ vlerëson se përditësimi i Esse3 me të gjitha modulet e parashikuara do të garantojë monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, si dhe do të mundësojë raportime dhe statistika të plota e të dedikuara për të gjitha palët e interesuara për këtë program studimi. GVJ konstatoi se monitorimi i aktivitetit akademik dhe administrativ realizohet në mënyrë të kombinuar: përmes sistemit Esse3 monitorohet kryesisht pjesa e rezultateve të provimeve, ndërsa monitorimi i aspekteve të tjera vijon sipas mënyrës tradicionale përmes strukturave të përmendura më sipër (kriteri 1 dhe 2 i këtij</p>

	<p>standardi) në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe në nivel institucioni siç dokumentohet edhe në analizat vjetore përkatëse të veprimtarisë.</p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.6 rregullore esse 3.pdf; shtojca; shtojca 2.20 analiza e veprimtarisë së uk 2019-2020.pdf; shtojca 3.8 analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë 2018-2019.pdf; shtojca 3.9 analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë kryesore 2019-2020.pdf; vizita në institucion]</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, gjatë vizitës në institucion (dhe deri në fund të kohës së përgatitjes së këtij raporti) GVJ konstatoi mos funksionimin e faqes zyrtare web të UK.</p> <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës me stafin dhe studentët e këtij program studimi rezulton se faqja funksionale web e UK ofron informacion në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) për të gjitha programet e studimit, personelin si dhe aktivitetet e ndryshme të institucionit.</p> <p>[Referenca: http://www.UK.edu.al/, RVB MP FK 2021.pdf; vizita në institucion]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare të kostove sipas programeve të studimit por harton një raport mbi veprimtarinë financiare në nivel universiteti dhe për periudha vjetore që përkrijnë me vitin buxhetor, i cili fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.</p> <p>Ky raport financiar që përgatitet nga Administratori i UK, i referohet pasqyrave financiare vjetore që institucioni, në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi, dorëzon në përfundim të vitit financiar pranë MASR dhe Degës së Thesarit Korçë. Raporti mbi veprimtarinë financiare është pjesë e analizës vjetore të UK. Gjatë takimit me drejtuesit e institucionit, GVJ u informua se treguesi kosto mesatare për student përllogaritej si një mesatare e thjeshtë e shpenzimeve të realizuara në nivel institucioni (dhe të mbuluara nga buxheti i</p>

	<p>shtetit) kundrejt numrit total të studentëve (të ciklit të parë dhe të dytë). Për periudhën 2018-2020, ky tregues paraqitej si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Viti 2018 - kosto mesatare 64'706 lekë për student; ▪ Viti 2019 - kosto mesatare 86'097 lekë për student; ▪ Viti 2020 - kosto mesatare 114'877 lekë për student. <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 2.20 analiza e veprimtarisë së uk 2019-2020.pdf; shtojca 3.10 kosto mesatare për student.pdf; shtojca 3.36 buxhetet e UK.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtje e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Sipas statutit të ndryshuar të UK projektbuxheti vjetor hartohet në nivel institucioni nga Administratori, në përputhje me propozimet e bëra prej njësive kryesore dhe njësive bazë dhe në zbatim të planit buxhetor afatmesëm të miratuar nga Bordi i Administrimit të UK. Në takimin me stafin akademik të programit, GVJ u informua se njësia bazë si pjesë të analizës vjetore përfshin dhe propozimet për parashikime financiare në funksion të programeve të studimit lidhur me investime në pajisje, infrastrukturë, pasurim bibliotekë, aktivitete shkencore etj. Në raportet financiare të përgatitura në nivel institucioni, shpenzimet janë të klasifikuara kryesisht sipas natyrës së tyre në grupet kryesore si: paga, shpenzime operative, për investime, për kërkim dhe të tjera, ndërsa të ardhurat janë të klasifikuara sipas burimeve të parashikuara të financimit si: buxheti i shtetit, grante për kërkim, tarifat nga studentët, të ardhura nga sponsorizime, të ardhura nga shërbimet dhe veprimtari të tjera etj.</p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 1.21 rregullore e bordit të administrimit.pdf; shtojca 3.36 buxhetet e UK.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB, organigramës dhe Statutit të ndryshuar të UK, rezulton se Njësia e Auditimit të Brendshëm, në varësi të Bordit të Administrimit, është përgjegjëse për kontrollin dhe auditimin e brendshëm vjetor të institucionit. Gjithashtu, UK i nënshtrohet auditimit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm MASR.</p> <p>GVJ konstatoi se raporti i fundit i këtij auditimi fokusohet në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, të riskut, në vlerësimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së institucionit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në dhënie opinionit mbi pasqyrat financiare si dhe në dhënie rekomandimesh për përmirësime në arritjen e objektivave të institucionit.</p>

	<p>Auditimi i jashtëm i UK, realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe fokusohet kryesisht në auditimin e pasqyrave financiare dhe të pajtueshmërisë së veprimtarisë së institucionit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Raporti më i fundit i auditimit nga KLSH i referohet periudhës 2016-2017 dhe rezulton me një opinion të kualifikuar mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për këtë periudhë pasi janë konstatuar disa anomali materiale, por jo të përhapura, në plotësimin e pasqyrave financiare dhe disa devijime nga kuadri rregullator i veprimtarisë së institucionit.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 2.34 organograma e universitetit.pdf; dokument shtesë 3 raporti i fundit i auditimit.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare të dedikuara në mbyllje të një cikli të plotë studimi dhe sipas programeve të studimit, por harton një raport vjetor të analizës së veprimtarisë në nivel institucioni.</p> <p>Në këtë raport analizohet veprimtaria financiare e UK mbi bazë viti buxhetor si dhe bëhet edhe një analizë krahasuese e realizimit të të ardhurave dhe kryerjes së shpenzimeve kundrejt shumave të buxhetuara më parë.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 2.20 analiza e veprimtarisë së uk 2019-2020.pdf; shtojca 3.36 buxhetet e UK.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Sipas statutit të ndryshuar të UK dhe në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi, burimet e financimit të universitetit janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimimin; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore-shkencore.</p> <p>Në rregulloren financiare të miratuar nga Bordi i Administrimit i UK përcaktohet mënyra e përdorimit të të ardhurave (përveç atyre nga buxheti i shtetit dhe pagesat nga studentët) në funksion të veprimtarisë dhe nevojave të institucionit për paga, shpenzime operative, investime dhe kërkim shkencor.</p> <p>Udhëzimi i MFE “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” përcakton se fondet e buxhetit të shtetit për arsimin e lartë janë në formën e grantit që për çdo universitet shpërndahet në fillim të vitit buxhetor nga MASR. Më pas universitetet nëpërmjet organeve kolegjiale e detajojnë këtë grant sipas</p>

njësive shpenzuese dhe zërave përkatës të buxhetit të planifikuar prej tyre. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se për periudhën 2018-2020 ecuria e të ardhurave të realizuara dhe shpenzimeve të kryera paraqitet si vijon:

Zëri / Viti	2018	2019	2020
Të Ardhurat			
- Buxheti i shtetit	72.8%	85.9%	84.7%
- Tarifat nga studentët	23.7%	13.2%	14.7%
- Të tjera të ardhura	3.6%	1.0%	0.6%
<i>Tot</i>	<i>100.0%</i>	<i>100.0%</i>	<i>100.0%</i>
Shpenzimet:			
- Paga	83.3%	83.4%	85.7%
- Operative	6.1%	14.5%	11.3%
- Investime	10.4%	1.0%	0.7%
- Kërkimi	0.2%	1.0%	2.3%
<i>Tot</i>	<i>100.0%</i>	<i>100.0%</i>	<i>100.0%</i>

Konstatohet një rënie në të ardhurat nga tarifat e studentëve dhe të ardhurat e tjera si pasojë kryesisht e pandemisë Covid-19 dhe e një tendence rënëse në numrin e studentëve në nivelin bachelor. Trendi i shpenzimeve është relativisht i qëndrueshëm dhe aktualisht menaxhimi i shpenzimeve buxhetore realizohet nga njësia shpenzuese në varësi të Rektoratit të UK, në përputhje me kërkesat e njësive bazë.

[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 1.3.1 draft plani strategjik i zhvillimit.pdf; shtojca 1.8.1 rregullorja financiare.pdf; shtojca 2.20 analiza e veprimtarisë së uk 2019-2020.pdf; shtojca 3.36 buxhetet e UK.pdf; vizita në institucion]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në dokumentacionin shoqëruar dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve të programit të studimit “Master Profesional në Financë-Kontabilitet” janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe Statutin e UK.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Barazia e të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit garantohej edhe nga kërkesat (nenet) specifike të Statutit të UK dhe të rregulloreve respektive të njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Në Statut dhe në këto rregullore, parashikohen qartë kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në programe të tjera.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Pranë Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, përgjegjës për këtë program studimi, ngrihet një komision që merret me renditjen e kandidatëve për studentë bazuar në përlllogaritjen e pikëve totale sipas ponderimit të fushës së studimit bachelor dhe notës mesatare me koeficientët përkatës. Fituesit shpallen nga Komisioni vlerësues i FE, pas shqyrtimit final të kërkesave dhe renditjes së mësipërme, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Sipas parashikimeve në Statut dhe në rregulloret e sipërcituara, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit propozon çdo vit kriteret e përzgjedhjes në programin e studimit “Master Profesional në Financë-Kontabilitet” dhe kuotat e pranimit të studentëve në përputhje me kapacitetet në dispozicion dhe me standardet e cilësisë, të cilat më pas miratohen nga Dekanati i FE dhe në nivel institucioni nga Senati Akademik i UK.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Këto kriteret dhe kuota të pranimit, pas marrjes së miratimit sipas kuadrit rregullator, bëhen publike nga UK përpara fillimit të aplikimeve për pranimet në ciklin e dytë të studimeve, përmes publikimeve në ambientet e universitetit, fletëpalosjeve dhe guidave, publikimeve në faqen zyrtare web të universitetit, në</p>

	<p>mediat lokale të komunikimit, në rrjetet sociale, si dhe takimeve të drejtpërdrejta me të interesuarit.</p> <p>[Referenca: shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar universitetit.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf; shtojca 3.27 fletëpalosje informuese.pdf; vizita në institucion]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparëshme në rast transferimi studimesh.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparëshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në Rregulloren e PS (pikë 16) dhe në Rregulloren e Njësisë Kryesore (kapitulli 11) jepet informacion i plotë lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe periudhave të mëparëshme të studimit. Në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi çdo vit pranë departamentit të Financë-Kontabilitetit ngrihet një komision me tre anëtarë për vlerësimin dhe ekuivalentimin e dosjeve të kandidatëve për transferim studimesh dhe për program të dytë studimi i cili diskuton dhe propozon kriteret e këtij vlerësimi.</p> <p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët e programit të studimit “Master Profesional në Financë-Kontabilitet” informohen në lidhje me programin e studimit, organizimin e vitit akademik dhe kuadrin rregullator përkatës që në momentin e regjistrimit pranë UK, si dhe më pas në mënyrë të vazhdueshme nga stafi akademik i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, nga sekretaria mësimore e FE, nëpërmjet platformës Esse3 si dhe nga strukturat e tjera ndihmëse të institucionit.</p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.23 për vlerësimin dhe ekuivalentimin e dosjeve të</p>

	<i>kandidatëve për transferim.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit.pdf; vizita në institucion]</i>			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstaton se në përputhje me parashikimet e Statutit dhe të Rregullores së UK, në rregulloren e këtij programi studimi jepet informacion i plotë mbi vlerësimin e vazhduar dhe përfundimtar të programit mësimor të parashikuar. Gjithashtu në pikën 15 të kësaj rregulloreje, sqarohet edhe procedura e diplomimit duke ju referuar shlyerjes së detyrimeve lidhur me programin e studimit, si kusht i domosdoshëm për të vijuar procesin.			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Aktualisht ky program studimi parashikon përgatitjen e një punimi diplome me karakter zbatues, të udhëhequr nga pedagogu i propozuar prej studentit dhe i miratuar nga përgjegjëse e departamentit. Studentëve u vihet në dispozicion edhe udhëzuesi i përgatitjes së diplomës master profesional sëbashku me formatin e vlerësimit të punimit nga udhëheqësi. Në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët ishin të mirëinformuar lidhur me këto kritere dhe procedura. <i>[Referenca: shtojca 2.31 udhëzuesi i diplomes master profesional.pdf; shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit.pdf; shtojca 3.34 format vlerësimi i punimit të diplomës.pdf; vizita në institucion]</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UK përdor publikimin e rregulloreve në ambientet e institucionit si dhe harton fletëpalosje dhe komunikime informuese në rrjetet sociale dhe në median lokale, si udhëzues për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi të gjitha programet e studimit. <i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 3.20 analiza e veprimtarisë së qendrës së karrierës & alumni 2019-2020; shtojca 3.27 fletëpalosje informuese rreth programeve të studimit; vizita në institucion]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit “Master Profesional në Financë-Kontabilitet” informohen nga

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>pedagogët e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, Kordinatori i Programit të Studimit (personel akademik me kohë të plotë pranë departamentit), Sekretaria Mësimore e FE dhe Qendra e Karrierës dhe Alumnit (QKA), për të gjithë detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi (struktura mësimore, orari mësimor, kalendari i provimeve, rezultatet, rregulloret etj.).</p> <p>Gjithashtu në dispozicion të studentëve, në ambientet e institucionit dhe platformën Esse3, janë edhe materialet informuese si fletëpalosje, si dhe manuale e udhëzues përdorimi të përgatitur nga UK dhe mbi lëndët e programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 2.13 programi i praktikës profesionale mësimore.pdf; shtojca 2.18 manual për mësimin online.pdf; shtojca 2.31 udhëzuesi i diplomes master profesional.pdf; shtojca 3.16 model mësimi online.pdf; shtojca 3.27 fletëpalosje informuese rreth programeve të studimit; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësuesin e Qendrës së Karrierës dhe Alumni gjatë vizitës në institucion, rezultoi se kjo strukturë kujdesej për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit në fund të ciklit të studimeve. Struktura mbështetëse kryesisht në informacionin e publikuar në platformat publike, shtetërore si dhe kontaktet me sipërmarrjet private. Megjithë burimet e kufizuara (vetëm një specialist) falë edhe angazhimit vullnetar të studentëve, pranë kësaj strukture organizohen këshillime dhe trainime si p.sh. moduli për karrierën për të ndihmuar studentët në aktivitete si shkrimi i CV-së, i letrës së interesit, punimit të diplomës, kërkim i vendit të punës, përgatitja për intervistë pune etj.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.20 analiza vjetore qendra e karrierës e alumit.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se Koordinatori i Programi të Studimit, pedagogët e departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe sekretaria mësimore luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Nëpërmjet faqes web zyrtare të UK, hapësirës së dedikuar në platformën Esse3 dhe kredencialeve individuale, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, mund të konsultojnë syllabuset dhe materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët, vlerësimet sipas lëndëve që kanë frekuentuar, orarin e provimeve, etj, si dhe të informohen lidhur me infrastrukturën dhe aktivitete të tjera që organizohen në nivel universiteti.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Gjithashtu në dispozicion të studentëve, në ambientet e institucionit dhe platformën Esse3, janë edhe materialet informuese si fletëpalosje, si dhe manuale e udhëzues përdorimi të përgatitur nga UK dhe mbi lëndët e programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 2.13 programi i praktikës profesionale mësimore.pdf; shtojca 2.18 manual për mësimin online.pdf; shtojca 2.31 udhëzuesi i diplomes master profesional.pdf; shtojca 3.16 model mësimi online.pdf; shtojca 3.27 fletëpalosje informuese rreth programeve të studimit; vizita në institucion]</i></p>

	[Referenca: shtojca 2.5 rregullorja e programit të studimit.pdf; https://moodle.unkorce.rash.al/login/index.php? ; vizita në institucion]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																		
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UK mban dhe disponon statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit.																		
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria mësimore e FE mbledh, regjistron dhe përditëson të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi, për ecurinë mësimore të tyre gjatë ciklit të studimeve dhe diplomimin e tyre. Regjistrat në sekretari (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i lëshimit të diplomave) janë të formatuar sipas standardeve shtetërore. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve.																		
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit “Master Profesional në Financë-Kontabilitet dhe konstatoi plotësinë e tyre. Të dhëna për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi janë:																		
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Të diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017-2018</td> <td>55 studentë</td> <td>45 studentë</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>34 studentë</td> <td>30 studentë</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>36 studentë</td> <td>22 studentë</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>35 studentë</td> <td>në proces</td> </tr> <tr> <td>2021 - 2022</td> <td>35 studentë</td> <td>në proces</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Të regjistruar	Të diplomuar	2017-2018	55 studentë	45 studentë	2018-2019	34 studentë	30 studentë	2019-2020	36 studentë	22 studentë	2020-2021	35 studentë	në proces	2021 - 2022	35 studentë	në proces
Viti akademik	Të regjistruar	Të diplomuar																	
2017-2018	55 studentë	45 studentë																	
2018-2019	34 studentë	30 studentë																	
2019-2020	36 studentë	22 studentë																	
2020-2021	35 studentë	në proces																	
2021 - 2022	35 studentë	në proces																	
	Shifrat e regjistrimeve në këtë program studimi gjatë harkut kohor 2018-2021 flasin për një qëndrueshmëri të numrit të																		

	<p>regjistrimeve në përputhje dhe me kapacitetet e parashikuar të këtij PS. Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.1.1 drafstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 1.10 rregullore e sekretarisë mësimore.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstaton se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UK. Pranë sekretarisë mësimore informacioni ruhet në formatin letër dhe në sistemin e menaxhimit informatik ruhet në versionin elektronik. Të dyja mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet njësisë bazë analizon profilin dhe cilësinë në hyrje të studentëve (nota mesatare), si dhe ndërton statistika të cilësisë (nota mesatare) dhe të kalueshmërisë (në %) sipas lëndëve dhe programeve të studimit (analizat vjetore të departamentit dhe FE). Ndërkohë Qendra e Karrierës dhe Alumni, mbledh dhe mban statistika mbi punësimin e studentëve dhe rrjetin alumni, si dhe harton raporte në bashkëpunim me njësitë bazë dhe strukturat e tjera të UK.</p> <p>Në takimin e zhvilluar me përfaqësuesin e QKA, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se aktualisht kjo strukturë ka vetëm një specialist dhe se ka nevojë për më shumë burime njerëzore për të mundësuar një raportim më të plotë, të saktë dhe në kohë të raporteve periodike të përgatitura prej tyre.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.10 rregullore e sekretarisë mësimore.pdf; shtojca 3.23 raport vjetor mbi cilësinë në hyrje dalje dhe punësimin të studentëve.pdf; shtojca 3.35 pyetësor alumni dhe relacioni mbi veprimtarinë për 2020.pdf; shtojca 3.8 analiza vjetore e njësisë bazë; shtojca 3.9 analiza vjetore e njësisë kryesore 2019-2020.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.5
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezulton se UK ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik të UK, në Bordin e Administrimit, në Këshillin e Etikës, si dhe ngritjen dhe mbështetjen financiare të Këshillave Studentore në nivel Fakulteti dhe në nivel Universiteti, në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e UK.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjithashtu studentët kanë përfaqësuesin e tyre edhe pranë Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të UK si dhe pranë Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të FE, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit .pdf; shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 3.3 vendimi i njësisë bazë për ngritjen e gvb.pdf; shtojca 3.4 lista e njsbc.pdf; dokument shtesë 4 vendimi për ngritjen e njsbc struktura.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UK, rezulton se në hartimin dhe ndryshimet e bëra në kohë në programin e studimit “Master Profesional në Financë-Kontabilitet” është mbajtur parasysh ngarkesa akademike e studentëve. Gjithashtu, shpërndarja e krediteve dhe syllabuset e lëndëve janë të strukturuar në mënyrë të tillë që lehtësojnë procesin e transferimit të studentëve si nga jashtë UK ashtu dhe brenda FE të UK.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përveç përfshirjes së studentëve në vendimmarrje, përmes strukturave të garantuara nga statuti dhe rregulloret e UK, GVJ konstatoi se institucioni përdor edhe pyetësorin online për studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe stafit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Në takimin me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi se rezultatet këtyre pyetësorëve, megjithë pjesëmarrjen e ulët të studentëve, janë objekt diskutimi në strukturat përkatëse të UK dhe bëhen pjesë e analizës vjetore dhe planit të masave për përmirësim që ndërmerr departamenti në përgjithësi dhe në lidhje me programin e studimit në veçanti.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 2.7 plani mësimor i programit të studimit.pdf; shtojca 2.15 dokument për ndryshimet në planet mësimore.pdf; shtojca 3.8 analiza vjetore e njësisë bazë; shtojca 3.9 analiza vjetore e njësisë kryesore 2019-2020.pdf; shtojca 3.13 pyetësori studentor fund kursi.pdf; shtojca 3.14 pyetësori i stafit akademik.pdf; vizita në institucion]</i></p>


<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e UK, Rregullorja e FE dhe Rregullorja e Departamentit, në nenet përkatëse, parashikojnë të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, kundrejt një kërkesë me shkrim që i drejtohet Dekanit të FE brenda 8 ditëve nga dita e provimit me shkrim. Kërkesat dorëzohen pranë personelit ndihmës akademik në departament. Pas sqarimeve të nevojshme me përgjegjësen e departamentit, komisionin e provimit dhe studentin, Dekani brenda dy ditëve vijon me komunikimin e vendimit përkatës. Në rast se ankesa është e drejtë, studentit i jepet e drejta të rijapë provimin me një komision të ri në një datë tjetër por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Gjithashtu studentët mund të shprehin mendimin e tyre lidhur me cilësinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve edhe në pyetësorët përkatës të realizuar nga departamenti dhe në nivel institucioni.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësisë bazë.pdf, vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në Statutin dhe rregulloret e UK dhe të programit të studimit përcaktohen procedurat dhe njësitë/strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaria mësimore, Kordinatori i programit të studimit, Qendra e Karrierës dhe Alumnit (QKA) si dhe Qendra Rinore & Sportive.</p> <p>Sekretaria mësimore dhe Kordinatori i programit të studimit, luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, rregulloret, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Kordinatori i programit të studimit, në bashkëpunim me QKA, kujdeset për edhe organizimin e praktikave profesionale, mban kontakt të vazhdueshëm me studentët për problematikave e ndryshme që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe bën raportimin e tyre në departament.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .</p>	
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e</p>	

<p>këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në takimin me përfaqësuesin e Qendrës së Karrierës dhe Alumnit dhe Qendrës Rinore & Sportive, struktura pranë Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional të UK, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se këto struktura mbuloreshin aktualisht nga një specialist i vetëm, i cili shërbente si referues dhe këshillues për informimin dhe orientimin e të gjithë studentëve (potencialë dhe aktualë) lidhur me politikën, rregulloret dhe procedurat e studimit në UK, mundësitë për mbështetje financiare, mundësitë për realizim praktikash profesionale, si dhe për aktivitetet e ndryshme që nxisin jetën shkencore, kulturore, sportive të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Në këtë proces, specialisti mbështetj edhe në angazhimin vullnetar të studentëve pranë këtyre qendrave. Përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme si trainime, takime informuese, tryeza të rrumbullakta, përdorimit të rrjeteve sociale profesionale, përditësimit të bazës së të dhënave mbi punëdhënësit, etj, QKA synon të nxisë pjesëmarrjen aktive të studentëve, si dhe të rrisë mundësitë e punësimit të tyre.</p> <p>Gjithashtu, në bashkëpunim me strukturat e tjera të UK (njësitë bazë përkatëse), QKA merret edhe me përgatitjen e statistikave e informacioneve të përditësuara lidhur me zhvillimin e karrierës së studentëve të diplomuar, pas përfundimit të studimeve.</p> <p><i>GVJ konstaton se raportimi lidhur me gjurmimin e studentëve ka nevojë për një analizë më të plotë dhe informacion të integruar prandaj rekomandojmë që pranë QKA të angazhohen burime njerëzore shtesë për të mundësuar efektivitet dhe raportim më cilësor të aktivitetit të kësaj strukture, që mbulon të gjithë institucionin.</i></p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 1.5 rregullore e drejtorisë së kurrikulave.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësive kryesore.pdf; shtojca 2.3 rregullorja e njësive bazë.pdf; shtojca 3.20 analiza vjetore qendra e karrierës e alumit.pdf; shtojca 3.23 raport vjetor mbi cilësinë në hyrje dalje dhe punësimit të studentëve.pdf; shtojca 3.35 pyetësor alumni dhe relacioni mbi veprimtarinë për 2020.pdf; vizita në institucion]</i></p>			

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se në UK Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet kryesisht nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) me përfaqësues nga çdo njësi kryesore. Në nivel njësie kryesore, funksionojnë edhe Grupet e Vlerësimit të Brendshëm me përfaqësues nga çdo njësi bazë dhe një përfaqësues nga studentët. Struktura e NJSBC-së është pjesë e Sektorit të Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni, pranë Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional. Në Statutin dhe rregulloret e institucionit, përcaktohet qartë funksionimi dhe përgjegjësia e kësaj strukture, që synon sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë, në pajtim të plotë me standardet shtetërore, si dhe standardet dhe udhëzimet europiane përkatëse. Gjithashtu, UK ka hartuar dhe përdor Manualin e Cilësisë si një kornizë të parimeve themelore mbi mënyrën e sigurimit, kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se në planin strategjik të zhvillimit të UK, i kushtohet një vëmendje e veçantë vlerësimit të cilësisë me fokusin e akreditimit të programeve të studimit. Gjithashtu në kalendarin e veprimtarisë të NJSBC-së përfshihen takime të rregullta me studentët për të përmirësuar përfshirjen e tyre në procesin e anketimeve për dhënie vlerësimi lidhur me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 1.16 manuali i cilësisë.pdf; shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 1.3.1 draft plani strategjik.pdf; shtojca 1.5 rregullore drejtorja e kurrikulave.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në vitin 2017, UK iu nënshtrua procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditimin institucional dhe ka marrë vlerësimin përfundimtar pozitiv, nga Bordi i Akreditimit. Gjatë vitit 2019 është akredituar grupi i parë i programeve të studimit (8 programe të ciklit të parë dhe një program studimi me karakter profesional) dhe gjatë 2021 ka vijuar puna për akreditimin e grupit të dytë të programeve të studimit. Gjatë</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të</p>	<p>Në vitin 2017, UK iu nënshtrua procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditimin institucional dhe ka marrë vlerësimin përfundimtar pozitiv, nga Bordi i Akreditimit. Gjatë vitit 2019 është akredituar grupi i parë i programeve të studimit (8 programe të ciklit të parë dhe një program studimi me karakter profesional) dhe gjatë 2021 ka vijuar puna për akreditimin e grupit të dytë të programeve të studimit. Gjatë</p>


<p>tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>vizitës në institucion, GVJ konstatoi angazhimin e të gjitha strukturave të UK për plotësimin e rekomandimeve të lëna nga ekspertët dhe shfrytëzimin e eksperiencës së krijuar gjatë këtij procesi si një instrument krahasues. Manuali i Cilësisë përfshin dhe një përmbledhje të dokumentave model në funksion të përmbushjes së standardeve të cilësisë, në pajtim me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. GVB i FE përgatit raportin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të ciklit të parë dhe të dytë me qëllim vlerësimin sa më objektiv të përmbushjes së standardeve të cilësisë në nivel njësie kryesore. Ky raport është pjesë e analizës vjetore që realizohet në nivel departamenti dhe fakulteti në shërbim të përmirësimit të cilësisë.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.3.1 draft plani strategjik i zhvillimit.pdf; shtojca 1.16 manuali i cilësisë uk 2020 .pdf; shtojca 1.5 rregullore e drejtorisë së kurrikulave.pdf; shtojca 3.7 raportet vjetore të njsbc.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se në UK Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë konsiderohet një proces gjithëpërfshirës, në të cilin bashkëpunojnë të gjitha strukturat e UK.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë çdo vit harton kalendarin e veprimtarisë në përputhje me planin vjetor të Drejtorisë përkatëse, në të cilin përfshihen aktivitete si ndjekja e gjetjeve të evidentuara në raportet e GVB, realizimi i anketimit elektronik (pyetësorët) me studentët mbi cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UNICO dhe analiza e rezultateve të tij, ndryshimet në syllabuset, organizimi i takimeve me studentët etj. Rezultatet e këtyre aktiviteteve bëhen pjesë e analizave vjetore në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe institucioni. GVJ vlerëson se bashkëpunimi NJSBC-së me njësinë bazë dhe komunikimet e rregullta me të gjitha strukturat e UK lidhur me politikën dhe praktikën që lidhen me sigurimin e cilësisë në institucion, ndihmon në krijimin e një kulture cilësie në rang institucioni.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.3.1 draft plani strategjik i zhvillimit.pdf; shtojca 1.16 manuali i cilësisë uk 2020 .pdf; shtojca 1.5 rregullore e drejtorisë së kurrikulave.pdf; shtojca 3.7 raportet vjetore të njsbc.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, Statutin dhe rregulloren e UK, GVJ konstatoi se monitorimi, shqyrtimi, mbikëqyrja dhe rishikimi i programeve të studimit të ciklit të dytë të realizohet nga disa struktura:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni, (SKVIA) pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor; ▪ Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor pranë çdo njësie bazë; ▪ Zëvendës Rektori për mësimin; <p>në bashkëpunim me strukturat dhe personelin akademik të fakultetit dhe departamentit përgjegjës për programin e studimit.</p> <p><i>[Referenca: shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 1.5 rregullore e drejtorisë së kurrikulave.pdf; shtojca 2.2 rregullorja e njësisë kryesore.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Në takimin me përfaqësuesin e NJSBC-së dhe me personelin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi se në UK përdoren procedura formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza semestrale dhe vjetore.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Çdo fillim viti akademik në departament miratohen syllabuset e lëndëve sipas programeve dhe reflektohen propozimet e pedagogëve për ndryshime në to bazuar në eksperiencën e krijuar, në studime të tregut, në propozimet e bashkëpunëtorëve, në komentet e studentëve, si dhe në pajtim të plotë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi si dhe pyetësori i pedagogëve për vetëvlerësim të performancës së mësimdhënies. Manualin e Cilësisë i UK, shërben si metodologjia bazë në gjithë procesin e sigurimit, kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi se në nivel universiteti, SKVIA me NJSBC hartojnë kalendarin e procesit të vetëvlerësimit, si pjesë e planit vjetor të punës së kësaj strukture, si dhe monitorojnë realizimin e tij. Gjithashtu kjo strukturë është e anagazhuar edhe në monitorimin e</p>

	<p>mbarëvajtjes së procesit mësimor, në përgatitjen e programeve të reja për të gjitha ciklet e studimit, si dhe realizon rishikimin periodik të programeve ekzistuese që ofrohen në UK.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.2 rregullorja e uk.pdf; shtojca 1.16 manuali i cilësisë uk 2020 .pdf; shtojca 1.5 rregullore e drejtorisë së kurrikulave.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në mbledhjet e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit në fund të çdo semestri mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, çështjet e evidentuara nga pyetësorët e studentëve, vlerësimet e pedagogëve, etj. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të përgatitur nga përgjegjësjë e departamentit dhe që i komunikohet Dekanatit të FE.</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Raporti i analizës vjetore përmban informacion sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, studentët, stafin akademik, bashkëpunimet, projektet dhe kërkimin shkencor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët dhe vlerësimet e tjera të realizuara. Raporti mbyllet me konkluzionet dhe rekomandimet për përmirësimin e problematikave të evidentuara. Bazuar në analizat vjetore në nivel njësie bazë, Dekanati harton raportin vjetor të njësisë kryesore, të strukturuar në mënyrë të ngjashme, që pasi diskutohet dhe miratohet nga Asambleja përkatëse dërgohet pranë Rektoratit të UK sipas kërkesave të kuadrit rregullator.</p> <p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi se raportet e vjetore të vlerësimit të NJSBC-së fokusohen në analizën e programeve të studimit, sipas cikleve, në nivel fakulteti dhe shoqërohen me komente mbi gjetjet dhe analiza mbi pikat e forta dhe të dobëta, si dhe mundësitë për përmirësime. Edhe këto raporte bëhen pjesë e diskutimeve dhe analizave vjetore në të gjitha nivelet (njësie bazë, njësi kryesore dhe nivel universiteti) dhe mbi rekomandimet e dhëna në to ndërtohen plane masash për përmirësimin e cilësisë duke filluar që nga njësia bazë. Në pajtim me kuadrin rregullator institucional këto plane masash për përmirësim, në nivel universiteti, miratohen nga Senati Akademik.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf;; shtojca 1.5 rregullore e drejtorisë së kurrikulave.pdf; shtojca 3.7 raportet vjetore njsbc.pdf; shtojca 3.8 analiza</i></p>



	<i>vjetore e njësisë bazë; shtojca 3.9 analiza vjetore e njësisë kryesore 2019-2020.pdf; vizita në institucion]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi se NJSBC përmes grupit përkatës pranë FE përgatit çdo vit një raport të vlerësimit të brendshëm të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të këtij fakulteti. Ky informacion është përfshirë në dosjen e vetëvlerësimit dhe komentet përkatëse janë mbajtur parasysh edhe në analizat periodike të departamentit me qëllim përmirësimin e vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 3.7 raportet vjetore njsbc.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Në Manualin e Cilësisë të UK përshkruhen parimet, procedurat dhe metodat për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë si dhe përfshihet një përmbledhje e dokumentave model që përdoren në këtë proces, në funksion të përmbushjes së standardeve të cilësisë sipas specifikës së programit të studimit. Në takimin me drejtuesen e departamentit dhe personelin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi se në UK përdoren metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit si: analiza bazuar në tregues të matshëm cilësisë si nota mesatare në hyrje, kalueshmëria sipas lëndëve/moduleve, vlerësime të punës së pedagogëve nga drejtuesi, organizimi i leksioneve të hapura, rishikime vjetore të syllabuseve, analiza e infrastrukturës në dispozicion të procesit mësimor si dhe përfshirja e eksperiencave më të mira ndërkombëtare, rezultat i angazhimeve të stafit akademik në projekte të ndryshme mësimore dhe kërkimore. <i>[Referenca: shtojca 1.16 manuali i cilësisë uk 2020 .pdf; shtojca 3.8 analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë.pdf; shtojca 3.17 model analiza në përfundim të një moduli.pdf; shtojca 3.22 propozime departamenti-rishikimi periodik i programeve.pdf; vizita në institucion]</i>
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në

<p>programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>takimet gjatë vizitës, GVJ konstatoi se në UK përdoren edhe teknikat e tërthorta të vlerësimit si pyetësorët e studentëve për vlerësimin e procesit mësimor në fund çdo semestri, pyetësorët e vetëvlerësimit të stafit akademik, pyetësori për alumni, si dhe raporte mbi cilësinë në hyrje dhe punësimin e studentëve.</p> <p>Megjithatë GVJ vlerëson se pjesëmarrja në pyetësorë e studentëve është relativisht e ulët dhe për pasojë raportet mbi rezultatet fokusohen më shumë në një analizë përshkruese. <i>Rekomandojmë përdorimin e instrumentave alternativë si kombinimi i shërbimeve që u ofrohen studentëve përmes platformave online dhe kujdesi për pasjen në gjendje pune të vazhdueshme të tyre, për të nxitur pjesëmarrjen e tyre.</i></p> <p><i>[Referenca: shtojca 3.8 analiza vjetore e njësisë bazë; shtojca 3.9 analiza vjetore e njësisë kryesore 2019-2020.pdf; shtojca 3.13 pyetësori studentor fund kursi.pdf; shtojca 3.14 pyetësori i stafit akademik.pdf; shtojca 3.20 analiza vjetore qendra e karrierës e alumit.pdf; shtojca 3.23 raport vjetor mbi cilësinë në hyrje dalje dhe punësimin të studentëve.pdf; shtojca 3.35 pyetësor alumni dhe relacioni mbi veprimtarinë për 2020.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në rregulloren e Drejtorisë së Kurrikulës & Vlerësimit Institucional (DKVI) përcaktohet qartë organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e strukturave/njësisve përbërëse si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Gjithashtu në Manualin e Cilësisë të UK paraqitet korniza e sigurimit të cilësisë në institucion, roli i strukturave akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të brendshëm si dhe inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin e sigurimit të cilësisë duke dhënë mendime</p>



	<p>përmes procedurave të vlerësimit (pyetësorëve) dhe angazhimit në strukturat qeverisëse të UK (Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisionet e ndryshme dhe Këshillat Studentorë).</p> <p>[Referenca: shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 1.16 manuali i cilësisë uk 2020 .pdf; shtojca 1.5 rregullore e drejtorisë së kurrikulave.pdf;]</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, statutin dhe rregulloret e UK, GVJ vlerëson se institucioni garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në takimin me drejtuesen dhe stafin akademik të këtij programi studimi, GVJ konstatoi se ky departament përditësohet dhe kontribuon në mënyrë të rregullt në procesin e vlerësimit të brendshëm me analiza, raporte dhe sugjerime mbi vlerësimet e bëra nga strukturat e DKVI. Në Kodin e Etikës së UK jepen parimet themelore të etikës në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, të detyrueshme për të gjithë komunitetin universitar dhe në raportet e tyre me aktorët e jashtëm, në përputhje me misionin dhe vizionin e institucionit. Gjithashtu, në këtë dokument shprehet qartë angazhimi i UK për respektimin e integritetit akademik dhe shmangien e të gjitha formave të diskriminimit dhe abuzimit duke adresuar në mënyrë të kujdesshme problemet etike me qëllim nxitjen e sjelljes së virtutshme si dhe parandalimin e sjelljeve joetike.</p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 1.20 kodi i etikës së UK.pdf; vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UK, GVJ konstaton se në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit synohet edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit. Pranë Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit organizohen tryeza të rumbullakta me ekspertë të fushës, ish-studentë, pedagogë dhe studentë programeve të studimit, të cilat shfrytëzohen edhe për ndarjen e mendimeve lidhur me cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit. Përfshirjes së mendimeve dhe ekspertizës së jashtme, në funksion të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit, i shërben edhe nisma më e re e institucionit, krijimi i “Bordit Këshillmor” të UK me</p>

	<p>përfaqësues nga institucionet publike lokale dhe nga sipërmarrjet private më të rëndësishme të zonës.</p> <p>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 3.8 analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë.pdf; shtojca 3.21 tryeza e rrumbullakët departamenti.pdf; dokument shtesë 6 krijimi i bordit këshillimor.pdf; vizita në institucion]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin e rezultateve të vlerësimeve të kryera nga drejtuesit e njësisë të vlerësuara si dhe publikimin e veprimtarisë së NJBSC-së në faqen zyrtare web të institucionit.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhëna personale.	GVJ nuk pati mundësi të vlerësonte publikimet në faqen zyrtare web të UK për shkak të mosfunksionimit të përkohshëm të kësaj faqeje, por gjatë takimeve të realizuara në institucion, me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, mori konfirmimin e tyre se këto publikime respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhëna personale. [Referenca: shtojca 1.1.1 draftstatuti i ndryshuar i universitetit.pdf; shtojca 1.5 rregullore e drejtorisë së kurrikulave.pdf; vizita në institucion]
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se raportet e vjetore të vlerësimit të NJSBC-së shoqërohen me komente mbi gjetjet dhe analiza mbi pikat e forta dhe të dobëta, si dhe mundësitë për përmirësime. Këto raporte bëhen pjesë e diskutimeve dhe analizave vjetore në të gjitha nivelet (njësi bazë, njësi kryesore dhe nivel universiteti) dhe mbi rekomandimet e dhëna në të ndërtohen plane masash për përmirësimin e cilësisë duke filluar që nga njësi bazë. Në pajtim me kuadrin rregullator institucional këto plane masash për përmirësim, në nivel universiteti, miratohen nga Senati Akademik.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Gjithashtu, GVJ konstatoi se në mbledhjet e departamentit, stafi akademik analizon në mënyrë periodike dhe aktive ecurinë dhe
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e	

afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	<p>problematikat e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe rekomandon masa për përmirësimin e cilësisë së procesit. Në kalendarin e veprimtarisë së NJSBC-së përfshihen takime të rregullta me stafin akademik dhe studentët me qëllim përditësimin e vijueshëm të tyre dhe për të nxitur pjesëmarrjen aktive në procesin e përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p><i>[Referenca: RVB MP FK 2021.pdf; shtojca 2.20 analiza e veprimtarisë së uk 2019-2020.pdf; 3.8 analiza vjetore e njësisë bazë; shtojca 3.9 analiza vjetore e njësisë kryesore 2019-2020.pdf; dokument shtesë 5 plane vjetore njsbc.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Niveli i lartë i përkushtimit dhe kualifikimi i stafit akademik të këtij programi studimi;
2. Infrastruktura fizike dhe organizative në dispozicion të Fakultetit të Ekonomisë e përshtatshme për një proces mësimor efektiv, krahasuar edhe me numrin aktual të studentëve;
3. Programi i studimit fokusohet në aspekte praktike dhe aplikative të financës dhe kontabilitetit;
4. Eksperienca e institucionit shërben si pikë referimi në tregun e punësimit rajonal;

b. Pika të dobta:

1. Koha e shkurtër për realizimin e praktikës profesionale dhe mungesa e një lënde të mirëfilltë të sektorit bankar, kufizon përfitimet nga ky program studimi;
2. Burime të kufizuara në stafin administrativ të QKA dhe NJSBC, ndikojnë cilësinë e raportimit nga këto struktura me pasoja në analizën e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, përgatitjen e raporteve për gjurmimin e studentëve pas diplomimit etj;
3. Niveli i ulët i angazhimit të stafit akademik dhe studentëve në mobilitete;

Rekomandime

1. Të rishikohet struktura e programit të studimit me objektivin e zgjatjes së praktikës profesionale, shtimit të një lënde bankare dhe ristrukturimit të lëndëve nga fusha e financave ndërkombëtare;
2. Të rishikohen dokumentat si rregullore e programit të studimit për të saktësuar gabimet dhe eleminuar dykuptimësitë;
3. Të shtohen burimet njerëzore dhe financiare në dizpozicion të strukturave si QKA dhe NJSBC, të cilat do të mundësojnë dhe hartimin e raporteve analitike mbi aktivitetin e këtyre strukturave;
4. Të hartohen raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel programi studimi dhe njësie bazë dhe të formalizohen aktivitetet me aktorët e jashtëm në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës së programeve të studimit;
5. Të hartohen analiza financiare të plota në nivel programi studimi;
6. Të rriten përpjekjet për nënshkrimin e marrëveshjeve me institucione homologe jashtë vendit me qëllim angazhimin e stafit akademik dhe të studentëve në mobilitete.

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program “Master Professional in Finance and Accounting”

a. Strengths and affirmations:

1. High level of commitment and qualification of the academic staff of this study program;
2. Physical and organizational infrastructure available to the Faculty of Economics is suitable for an effective learning process, compared to the current number of students;
3. The study program is focused on practical and applied aspects of finance and accounting fields, in accordance with the level of a “Master Professional” program;
4. The experience of the institution serves as a landmark in the regional labor market;

b. Weak points:

1. The short duration of the professional practice and the lack of a proper subject from the banking sector, limits the specter of the study program benefits;
2. Limited resources in the administrative staff of QKA and NJSBC, affect the quality of reporting by these structures influencing the quality of analysis on the benefits from cooperation agreements, reports for tracking students after graduation, etc;
3. Low level of engagement of academic staff and students in mobility projects;

Recommendations:

1. Revision of the current structure of the study program, to extend the professional practice duration, to enrich it with a banking subject and to restructure the international finance subjects;
2. Review of the regulatory acts as the regulation of the study program, to correct errors and eliminate ambiguities;

3. To increase the human and financial resources dedicated to structures such as QKA and NJSBC, which will help these structures to draft more accurate and analytical reports on their activities;
4. To prepare comprehensive reports analyzing the benefits and effectiveness of cooperation agreements and projects at the level of the study program and of the faculty and to formalize the activities with external actors to continuously improve the curriculum of the study programs;
5. To prepare financial reports according to study programs;
6. To make efforts to sign cooperation agreements with foreign high education institutions, aiming the mobility of the students and academic staff;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANACIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X